

Maj 2019.

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit Msc. në “Drejtësi”, me profile: “E drejtë penale”
dhe “E drejtë ndërkombëtare”, ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Evis Alimehmeti
Dr. Darinka Piqani




(Maj/2019)



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Humane
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 10, datë 16.01.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr. 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Drejtësi", me profile: "E drejtë penale"; "E drejtë ndërkombëtare"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Kolegji Universitar "Bedër"
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve	28 studentë
	Etj	



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc. në “Drejtësi”, me profile: “E drejtë penale”; “ E drejtë ndërkombëtare”

Programi nën vlerësim ofrohet nga Kolegji Universitar “Bedër”, i licencuar për ushtrimin e aktivitetit si Institucion i Arsimit të Lartë” me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (BEDËR), Tiranë”, themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë si organizatë jo fitimprurëse. Me Urdhërin Nr. 10, datë 16.01.2012 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë që përfundojnë me “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, nga ana e Institucionit është mundësuar zhvillimi i programit Master i Shkencave në “Drejtësi”. Studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profile: “E drejtë penale”; “E drejtë ndërkombëtare”, organizohen sipas sistemit me kohë të plotë. Programi realizohet me 120 ECTS. Studentët që përfundojnë me sukses programin Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profil: “E drejtë penale” pajisen me diploma Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profil: “E drejtë penale”. Studentët që përfundojnë me sukses programin Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profil: “E drejtë ndërkombëtare” pajisen me diplomë Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profil: “E drejtë ndërkombëtare”.

Programi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë i cili është njësi akademike shkencore brenda Fakultetit të Shkencave Humane. Departamenti ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në Drejtësi, konkretisht:

- Bachelor në Drejtësi
- Master i Shkencave në Drejtësi: Profili / E drejtë ndërkombëtare
- Master i Shkencave në Drejtësi: Profili / E drejtë penale

Programi ofrohet për studentë shqiptarë e të huaj të cilën zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e drejtësisë ose në fusha të afërta me drejtësinë. Bazuar në Vendimin Nr. 323 të Këshillit të Akreditimit, Ministria e Arsimit me Urdhërin Nr. 170, datë 20.04.2012 ka akredituar programin e studimit.


GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën:

Prof. Dr. Evis Alimehmeti dhe Dr. Darinka Piqani si ekspertë të jashtme vlerësimi për këtë program studimi. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Ersi Dako.

Më datë 20.05.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 6/61, datë 21.05.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, i hartuar nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit.

Përmes sistemit AMS, më datë 27.05.2019, si dhe me shkresë zyrtare Nr. 147/31 Prot., datë 27.05.2019, me lëndë “Komente rreth draftraportit të vlerësimit të jashtëm, për programin e



studimit Msc në "Drejtësi" me profile "E drejtë penale" dhe "E drejtë ndërkombëtare", Institucioni përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

GVJ, pasi lexoi me vëmendje komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

1. Plotësimi i rekomandimit (a) (fq. 4 e Draft-RVJ)

Në lidhje me komentin e Institucionit mbi observimin në disa pjesë të Draft-RVJ të GVJ në lidhje me kërkesat për personelin akademik që anagazhohet në programin Master Shkencor, është e vertetë që formulari i kriterëve mbi të cilin ngrihet raporti në Standardin III.2 ka kërkesë vetëm për titullarët në programin Master Shkencor. Ndërkohë sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe njëkohësisht kuadrit ligjor që ka vepruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri të arsimit të lartë, *personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës*. Sidoqoftë, në vlerësim edhe të shpjegimeve të dhëna nga Institucioni mbi natyrën e veprimtarive të personelit me Msc. që angazhohet pranë titullarëve me grada e titujt, kufizimit të kërkesës së standardeve të cilësisë vetëm tek kualifikimet e titullarit, si dhe objektit të kërkesës së rekomandimit të lënë, megjithë paqartësinë që mbart formulimi i këtij të fundit (konkretisht: *të krijohen mundësitë për të arritur në nivelin e kërkuar të përqindjes së stafit të brendshëm dhe kualifikimi i një pjese të tij në krahasim me atë të jashtëm*) është i mbështetshëm argumenti i reflektimit të këtij interpretimi e ndryshimit përkatës.

Për rrjedhojë, formulimi lidhur me plotësimin e rekomandimit (a) në RVJ (fq.8) ndryshon si vijon *"Gjithashtu, vihet re një përpjekje për përmbushjen e kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi duke angazhuar personel akademik me kualifikimin Doktor i Shkencave e sipër në nivelin e titullarëve të lëndëve. Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet i plotësuar."*


2. Plotësimi i rekomandimit (b) (fq. 4 e Draft-RVJ)

Në lidhje me komentin e Institucionit mbi konkluzionin e GVJ për plotësimin e rekomandimit lidhur me bibliotekën, GVJ ka marrë parasysh dhe ka njohur në vlerësimin e tij shtimin e fondit me burime elektronike. Megjithatë është fakt, i pakundërshtuar dhe nga Institucioni që biblioteka fizike paraqet akoma nevoja për përditësimin e titujve si dhe përfshirjen e literaturës së detyrueshme. Duke marrë parasysh të gjithë këta faktore, GVJ ka konkluduar në RVJ - dhe i qëndron këtij konkluzioni - që ky rekomandim konsiderohet *kryesisht* i plotësuar por në nevojë për t'u zhvilluar e konsoliduar më tej në drejtim të përditësimit të bibliotekës fizike.

3. Misioni/Objektivat e programit të studimit (pika 4, fq. 8 e Draft-RVJ)

Në lidhje me komentin mbi kriteret e përzgjedhjes së studentëve nga profilet e studimit në nivelin Bachelor, është i mirëpritur shpjegimi i Institucionit edhe në shembujt e sjellë për dallimin në përshtatshmërinë e profileve, por ka një mosplotësim të fjalisë sqaruese në komentin e institucionit që duhet plotësuar me qëllim që të kuptohet sqarimi i plotë.

4. Struktura akademike e fakultetit (pjesa përshkimore, fq. 10 e Draft-RVJ)



Sqarimi i Institucionit lidhur më mospërputhjen midis organigramës së institucionit (miratuar si shtojca Nr. 2 e Statutit; Tabela 1 e Aneksëve) dhe nenit 3 të Rregullores Themelore lidhur me qendrat shkencore është i mirëpritur nga GVJ. Gjithashtu kjo mospërputhje është një shembull tjetër i konstatimit nga ana e GVJ se rregullimi i detajuar nëpërmjet rregulloreve të shumta i strukturës organizative dhe i veprimtarisë akademike, shkencore dhe administrative, përveç se është një tipar pozitiv, mund të krijojë dhe mungesë koherence ndërmjet rregullimeve të ndryshme.

5. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

a. Komenti mbi konkluzionet e vlerësimit, pika 1, fq. 25 e Draft-RVJ

Ky koment adreson të njëjtën çështje të angazhimit të stafit akademik me grada e tituj si në komentin e parë (shih pikën 1 më lart). Fjalja e fundit e pikës së parë të konkluzioneve (fq. 30 e RVJ) bëhet *“Programi ka përgjithësisht një angazhim të përshtatshëm, me anagazhimin në nivelin e titullarëve të personelit akademik me kualifikimin Dr e sipër. Në nivelin e asistentit ka angazhim në një numër të vogël edhe të personelit me kualifikim Msc.”*.

Lidhur me stafin akademik janë pasqyruar gjithashtu ndryshime në: paragrafin e parë të fq. 20 të RVJ, si vijon: *“Kështu, në programin e çdo viti akademik në shqyrtim rezulton angazhim në nivelin e asistentëve të personelit akademik me Master Shkencor megjithëse në një numër të vogël në raport me angazhimin e lektorëve titullarë me grada e tituj”*; standardi II.1, fjalja e fundit, si vijon: *“Programi ka përgjithësisht një angazhim të përshtatshëm, me anagazhimin në nivelin e titullarëve të personelit akademik me kualifikimin Dr e sipër. Në nivelin e asistentit ka angazhim në një numër të vogël edhe të personelit me kualifikim Msc.”*; standardi III. 2, fjalja 3, si vijon: *“Në programin në vlerësim titullarët janë të gjithë të kualifikimit Doktor i Shkencave e sipër”*.

b. Komenti mbi konkluzionet e vlerësimit, pika 4, fq. 25 e Draft-RVJ

Në lidhje me komentin mbi kompetencat e Departamentit dhe të Këshillit të Departamentit, për sqarim të observimit të bërë nga ana GVJ: në rregulloret e Institucionit ka një qasje të veçantë në drejtim të përcaktimit të strukturave dhe kompetencave; kështu Departamenti është parashikuar si njësi me disa detyra ndërkohë që detyra të ngjashme janë parashikuar edhe për një organ tjetër brenda departamentit, Këshilli i departamentit që në përkufizimin që përmbahet në Rregulloren e Organizimit Akademik përfshin të gjithë anëtarët e departamentit, pra praktikisht përfaqëson në thelb vetë Departamentin.

Edhe pse në referencë të një forumi brenda departamentit parashikimi i kompetencave edhe për Këshillin e Departamentit do të ritheksohet në Raport (shih ndryshimet në RVJ, standardi II.4). Për të qenë në linjë edhe me parashikimet e Ligjit të Arsimit të Lartë mbi organizimin e strukturave të Institucioneve të Arsimit të Lartë mbetet i vlefshëm observimi për nevojën e thjeshtimit të rregullimeve të Institucionit mbi struktura e nën struktura, këshilla, koordinatore, bashkërendues, sekretarë, etj. Në këtë rast, referenca dhe rregullimi i kompetencave tek Departamenti do të ishte më përshtatshëm, edhe për shkak të parashikimit të tij si njësi brenda Institucionit.

Formulimi i konkluzioneve të pikës 4 (fq. 30 RVJ) bëhet “Në aktet e Institucionit është parashikuar Departamenti dhe Këshilli i departamentit që përfshin të gjithë anëtarët e departamentit. Këshilli i departamentit ka rregullim të përshtatshëm në drejtim të kompetencave; sidoqoftë referenca dhe rregullimi i kompetencave tek Departamenti si njësi akademike e shkencore do të ishte më përshtatshëm e do të evitonte mbivendosjen”.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

- a. Komenti mbi të dhënat sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit (fq. 33 e Draft-RVJ)

GVJ në Draft-RVJ (fq. 33-34) vë re se “Sipas RVB (fq. 59) gjatë periudhës gjashtë vjeçare objekt i këtij riakreditimi janë zhvilluar 12 anketime të tilla me studentë. Megjithatë nuk ka të dhëna specifike lidhur me numrin e përgjithshëm të studentëve të anketuar, përpunimin e të dhënave të dala nga këto anketime si dhe hapat e mëtejshëm të ndërmarrë nga njësitë përkatëse.”

Në komentet lidhur me këtë pikë, Institucioni bën referencë tek anketat e vitit 2016-2017¹ dhe 2017-2018² të cilat janë plotësuar nga studentët lidhur me Institucionin në përgjithësi.

Lidhur me këto dy anketa të zhvilluara, GVJ thekson se: së pari, këto janë anketa të studentëve lidhur me performancën e përgjithshme të institucionit dhe nuk pasqyrojnë vlerësimin e studentëve për programin e studimit në fjalë; së dyti, këto anketa pasqyrojnë vlerësimin e studentëve vetëm për dy vite akademike dhe jo për të gjithë periudhën që nga akreditimi i mëparshëm; së treti, evidenca shtesë e paraqitur së bashku me komentet e Institucionit, është e paqartë pasi përmban përqindjen e pjesëmarrjes së studentëve (në vlerësimet e lendëve) si për studimet bachelor dhe master, pa specifikuar të dhënat për programin e studimit në fjalë si dhe vitet e këtyre vlerësimeve. Gjithashtu, pavarësisht këtij dokumenti të paraqitur si evidencë shtesë, përsëri nuk ka “gjurmë” nëpër raporte te Komisionit apo Njësisë lidhur me përpunimin e të dhënave të dala nga këto vlerësime si dhe hapat e mëtejshëm të ndërmarrë nga njësitë përkatëse.

Sa më sipër, GVJ i qëndron formulimit dhe gjetjeve në Draft-RVJ dhe nuk e konsideron të nevojshme t’i ndryshojë ato.

- b. Komenti mbi kontrollin e brendshëm të cilësisë (fq. 34 e Draft-RVJ)


Në Draft-RVJ (fq. 34-35), GVJ bazuar në dokumentacionin e depozituar nga Institucioni ka konkluduar se “Nuk ka evidencë të raporteve [vjetore të Departamentit të Drejtësisë] për vitet e tjera akademike, si dhe të masave/hapave të ndërmarrë nga Rektorati/Senati/Departamenti për adresimin e pikave të dobëta” me përjashtim të raportit për vitin akademik 2016-2017.

Në komentet e tij, Institucioni sqaron se në evidenca është vendosur vetëm ky raport si shembull i raporteve vjetore dhe se këto raporte për vitet e tjera mund të gjenden në Departament apo Rektorat.

Ky sqarim i Institucionit nuk sjell ndryshim të gjetjeve nga GVJ të cilat bazohen vetëm në dokumentacionin dhe evidencat (përfshirë dhe ato shtesë në këtë fazë të vlerësimit) të

¹ http://qac.beder.edu.al/surveyStats/2016_2017.php

² http://qac.beder.edu.al/surveyStats/2017_2018.php



depozituara nga Institucioni në mënyrë zyrtare nëpërmjet sistemit përkatës. Për rrjedhojë, GVJ i qëndron formulimit në Draft-RVJ.

c. Komenti mbi vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre (fq. 35 e Draft-RVJ)

Është i mirëpritur sqarimi i Institucionit i mbështetur në evidencë konkrete (shtojca 2) lidhur me masat e ndërmarra nga grupi i auditimit të brendshëm për kontrollin e dokumentacionit të çdo njësie administrative dhe akademike për periudhën 2014-2016. Pjesë e këtij auditimi ka qenë dhe Departamenti i Drejtësisë.

Për pasojë, formulimi lidhur me këtë pikë në faqen 40 të raportit bëhet *“Grupi i auditimit të brendshëm në relacionin e datës 13 Shkurt 2017 ka bërë konstatimet përkatëse lidhur me përmbushjen e detyrave. Këto gjetje ia vënë në dijeni Rektorit. Nuk ka informacion lidhur me masat e ndërmarra nga Rekorati në drejtim të Departamentit lidhur me detyrat e papërmbushura.”*

d. Komenti lidhur me konkluzionet e vlerësimit (pika 3 e konkluzioneve, fq. 39 e Draft-RVJ)

Lidhur me sqarimin e Institucionit se NJSBC-ja “në lidhje me punësimin realizon studime gjurmuese” nëpërmjet zyrës së të diplomuarve, GVJ i mbetet qëndrimit të mbajtur në Draft-RVJ se edhe pse këto informacione mund të merren nga zyra e të diplomuarve, ato nuk pasqyrohen në asnjë nga aktivitetet monitoruese të NJSBC të paraqitura për vlerësim. Gjithashtu, Institucioni përmend se NJSBC përpara miratimit të Statutit të ri ka patur emërtim tjetër (Këshilli i Sigurimit të Cilësisë); megjithatë nëse ky Këshill ka funksionuar, emërtimi i ndryshëm nuk e pengon Institucionin të pasqyrojë aktivitetet monitoruese përkatëse.

Sa më lart, GVJ i qëndron gjetjeve dhe formulimeve në Draft-RVJ.

7. Komentet lidhur me programin e studimit, organizimin e tij

Në lidhje me përmirësimin e syllabuseve në disa lëndë, shpjegimi nga ana e Institucionit është i mirëpritur; sidoqoftë mbetet e rëndësishme që titulli i lëndëve të përmbushet në substancë nga temat që përmban syllabuset.

Sa më lart, GVJ i qëndron gjetjeve dhe formulimeve në Draft-RVJ.

8. Komenti lidhur me numrin e studentëve të diplomuar

Nga një ri-lexim i kujdesshëm i komentit të institucionit si dhe të dhënave në tabelat 25.1, 25.2 dhe 28, formulimi i pjesës përshkrimore “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve: numri i të punësuarve në përputhje me diplomën) dhe numri i të punësuarve jo në përputhje me diplomën” (fq. 60 e RVJ) bëhet: *“Sipas të dhënave të tabelës 28 (“Punësimi i studentëve), numri i të diplomuarve në programin e studimit Msc. në Drejtësi për periudhën 2013-2018 është 49. Këtu vihet re një mospërputhje e vogël me të dhënat nga tabelat 25.1 dhe 25.2 ku pasqyrohet cilësia në dalje e studentëve për çdo profil, por dhe numri i të diplomuarve i cili sipas përlllogaritjeve për periudhën 2013-2018 është 48 dhe jo 49.”*


ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të krijohen mundësitë për të arritur në nivelin e kërkuar të përqindjes së stafit të brendshëm dhe kualifikimi i një pjese të tij në krahasim më atë të jashtëm.
- b) Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e institucionit.
- c) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin “a”, GVJ konstaton se që nga akreditimi i mëparshëm, Institucioni ka bërë përpjekje për rritjen e numrit të personelit akademik efektiv (PAE) - në krahasim me atë të jashtëm (PAK) - të angazhuar në programin e studimit. Numri më i lartë i PAE ndër vite rezultoi në vitin akademik 2017-2018. Gjithashtu, vihet re një përpjekje për përmirësimin e kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi duke angazhuar personel akademik me kualifikimin Doktor i Shkencave e sipër në nivelin e titullarëve të lëndëve. **Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet i plotësuar.**
- b) Për rekomandimin “b”, GVJ vë re se Institucioni ka marrë masa për rritjen e numrit të titujve në bibliotekën e Institucionit si dhe titujve elektronikë. Megjithatë fondi i bibliotekës duhet përditësuar me tituj bashkëkohorë si dhe ai duhet të përfshijë tekstet dhe materialet e detyrueshme për të gjitha lëndët e ofruara për programin e studimit. **Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet kryesisht i plotësuar por në nevojë për t’u zhvilluar e konsoliduar më tej.**
- c) Për rekomandimin “c”, GVJ vë re se në disa lëndë të programit, gjuha angleze përdoret - plotësisht ose pjesërisht – si gjuhë e mësimdhënies. Gjithashtu, njohja e një nga pesë gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) në nivelin B1 konsiderohet si kriter hyrës në programin e studimit në fjalë. Kriteri i njohjes së një nga pesë gjuhët e lartpërmendura është në përputhje me nenin 76(4) të Ligjit për Arsimin e Lartë. **Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet i plotësuar.**



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit


Pjesa përshkimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi nën vlerësim ofrohet nga Kolegji Universitar “Bedër”, i licencuar për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011 “Për Licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (BEDËR), Tiranë”, themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë si organizatë jo fitimprurëse. Me Urdhërin Nr. 10, datë 16.01.2012 “Për Hapjen e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë që Përfundojnë me “Master Profesional”, “Master i Shkencave”, është mundësuar zhvillimi i programit Master i Shkencave në Drejtësi. Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Drejtësi, me profil: “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare” organizohen sipas sistemit me kohë të plotë. Programi synon t’i përgjigjet nevojave të tregut për specialistë në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare nëpërmjet edukimit dhe pajisjes së studentëve me njohuri të avancuara të karakterit shkencor në këto dy degë të rëndësishme të së drejtës.

Programi ofrohet për studentë shqiptarë e të huaj të cilën zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e Drejtësisë ose në fusha të afërta me drejtësinë. Sipas Rregullores së programit Master i Shkencave në “Drejtësi”, në profilin “E drejtë ndërkombëtare” mund të vazhdojnë studimet studentë që kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të parë pranë Kolegjit Universitar “Bedër” në Drejtësi ose në institucione të tjera në fushën Drejtësi/Juridik, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike dhe Programe të ngjashme studimi (pa përkufizim). Gjithashtu, mund të vazhdojnë studimet me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program edhe studentë që kanë një diplomë të ciklit të parë nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, të Kolegjit Universitar “Bedër”. Sipas rregullores së programit, fusha të tjera të ngjashme të cilat mund të shërbejnë për pranimin në programin e studimit Master në “E drejtë ndërkombëtare”, me plotësim kreditesh janë: Financë-Bankë, Administrim Biznesi, Menaxhim, Ekonomi, Teknologji Informacioni, Psikologji, Letërsi, Arkeologji, Shkenca Sociale, Gjuhë e Huaj, me një klauzolë përmbyllëse për fusha të tjera të ngjashme.

Në profilin “E drejtë penale” mund të vazhdojnë studimet edhe studentë që kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të parë pranë Kolegjit Universitar “Bedër” në “Drejtësi” ose në institucione të tjera në fushën Drejtësi/Juridik, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike dhe Programe të ngjashme studimi (pa përkufizim). Ndërkohë sipas rregullores së programit mund të ndjekin studimet pranë programit edhe studentë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë KU “Bedër”, me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program. Të njëjtën mundësi e kanë edhe studentë që kanë një diplomë të ciklit të parë nga institucione të tjera në degën Financë-Bankë, Administrim Biznesi, Menaxhim, Ekonomi, Teknologji Informacioni, Psikologji, Letërsi, Arkeologji, Shkenca Sociale.



Në vlerësim edhe të objektivave të programit për përgatitjen e specialistëve në fushën e së drejtës penale, nuk është e qartë si është vlerësuar rëndësia dhe përshtatshmëria e studentëve që kanë përfunduar studime në ciklin e parë për letërsi apo arkeologji për studime në fushën e së drejtës penale.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ³
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Referuar akteve të programit në vlerësim Misioni i Kolegjit Universitar "Bedër" është përgatitja e individëve të kualifikuar nëpërmjet një filozofie arsimimi që synon të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor me standarde të larta të përgatitjes e studentëve me nivel bashkëkohor nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit, zhvillimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës; në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit si dhe integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor.</p> <p>Gjithashtu, sipas rregullores së programeve të studimit të ciklit të dytë, neni 3, qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" është të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, për të ndërmarrë kërkime shkencore të vlefshme për specifikën shqiptare e atë ndërkombëtare. Në përmbushje të këtyre objektivave, referuar parashikimeve në Rregulloren e programit Master Shkencor në Drejtësi, respektivisht në profilin "E drejtë ndërkombëtare" dhe "E drejtë penale", programet kanë për qëllim arsimimin akademik dhe përgatitjen e studentëve me një formim të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë te</p>

³ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>kualifikuar në fushat respektive.</p> <p>Në raport me kërkesat e tregut të punës nga ana e Institucionit mbahen kontakte me subjekte dhe institucione të fushës së drejtësisë nëpërmjet marrëveshjeve institucionale për të vjelur gjithashtu vlerësime dhe ide në lidhje me përshtatshmërinë e programit, profileve dhe përthithjen nga tregu të të diplomuarve.</p> <p>Edhe pse ruajtja e vlerave kombëtare mund të identifikohet jo drejt për së drejti, duke ju referuar analizës së syllabuseve, mund të thuhet se programet e studimit në vlerësim zhvillojnë vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Institucioni ka miratuar Planin Strategjik 2018-2023 për zhvillimin e institucionit, hartuar nga Komisioni për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit të Kolegjit Universitar “Bedër”, e miratuar më 15.06.2017. Në Planin Strategjik të Institucionit identifikohen si misione në fushën e drejtësisë përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Këto objektiva konsiderohen nga ana e Institucionit si të rëndësishme në vlerësim të përpjekjeve për integrimin e Shqipërisë dhe rrjedhimisht në përputhje me kërkesat e tregut të punës për individë të kualifikuar konsiderohen të larta.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi Master Shkencor në “Drejtësi” me profilet në “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare” në drejtim të organizimit formal të tij është në përshtatshmëri me parimet e kuadrit rregullator të arsimit të lartë, parimet e organizimit të cikleve sipas Kartës së Bolonjës. Sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, programi Master Shkencor lidhet me nivelin 7 të Kornizës.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Plani Strategjik 2018-2023 në fuqi është hartuar nga Komisioni për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit të Kolegjit Universitar “Bedër”, miratuar më 15.06.2017.

Planet Strategjike kanë në vëmendje zhvillimin e cilësisë në mësimdhënie nëpërmjet zhvillimit të mendimit kritik, inovacionit, progresit, etj. Objektiva të tjerë përfshijnë zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë arsimore për të zhvilluar aftësitë praktike të studentëve, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përfitimim e dijeve në mënyrë të avancuar duke përfshirë edhe bashkëpunimin me institucione të huaja, cilësitë për kërkimin shkencor, zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me studentët në hyrje, përgjatë e pas diplomimit, nxitjen dhe përmirësimin e përgjegjësisë sociale duke zhvilluar angazhimin në aktivitete me impakt e kontribut për shoqërinë, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Referuar Statutit dhe Planeve Strategjike të Institucionit, qëllimi i programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”, me 2 profile është arsimimi akademik dhe përgatitja e studentëve me një formim të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive.
2. Institucioni ka një Plan Strategjik 5 vjeçar 2018-2023, miratuar më 15.06.2017. Planet Strategjike kanë në vëmendje zhvillimin e cilësisë në mësimdhënie nëpërmjet zhvillimit të mendimit kritik, inovacionit, progresit, etj.
3. Programi Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profile: “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare” në drejtim të organizimit formal të tij është në përshtatshmëri me parimet e kuadrit rregullator të arsimit të lartë, parimet e organizimit të cikleve sipas Kartës së Bolonjës.
4. Në vlerësim edhe të objektivave të programit për përgatitjen e specialistëve në fushën e së drejtës penale, mund të vlerësohet më mirë përshtatshmëria e pranimin në program të studentëve (edhe me plotësim kreditesh) që kanë përfunduar studime në ciklin e parë në disa degë të tilla si, letërsi, arkeologji, etj.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Në përputhje me kërkesat ligjore në nenin 20 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, institucioni i cili është një Kolegj Universitar, ka në përbërje të strukturës së tij akademike dy Fakultete dhe një qendër:

- Fakulteti i Shkencave Humane
- Fakulteti i Filologjise dhe Edukimit
- Qendra studimore ndërdisiplinore për studime të paqes dhe dialogut

Struktura përbërëse e institucionit reflektohet në Shtojcën 2 bashkëngjitur Statutit të Institucionit. Statuti i Institucionit është miratuar me vendimin Nr. 7 të Senatit Akademik, datë 21.07.2016 (*Evidenca Nr. 2 e DVV*).

Programi i studimit në fjalë ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane i cili, në përputhje me kërkesat e nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë, përbëhet nga tre Departamente (*Tabela 1 e Anekseve*):

- Departamenti i Drejtësisë;
- Departamenti i Shkencave Islame;
- Departamenti i Shkencave të Komunikimit.

Neni 8 i Statutit përcakton organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit. Në bazë të nenit 9 të Statutit, Senati Akademik “[...] është organ kolegjal vendimmarrës i Kolegjit Universitar “Bedër”, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht [...]”. Në bazë të nenit 10 të Statutit, Senati Akademik përbëhet nga 11 anëtarë ndër të cilët Rektori, Zv. Rektori, Dekanët e Fakulteteve, nga tre përfaqësues të fakulteteve të zgjedhur drejtpërdrejtë nga asambltetë e personelit akademik me kohë të plotë të njësive kryesore si dhe përfaqësuesi i studentëve. Senati akademik është një organ kolegjal me mandat 4 vjeçar, i cili mbledhet të paktën një herë në muaj. Ndërkohë, rektorati i Kolegjit Universitar “Bedër” është organ kolegjal ekzekutiv i cili përbëhet nga Rektori, Zv. Rektori, Dekanët e fakulteteve dhe Administratori i Kolegjit (*neni 16 i Statutit të institucionit*).

Në bazë të nenit 19 të Statutit, dekanati i KU është organi kolegjal ekzekutiv i njësisë përkatëse, pra fakultetit. Dekanati përbëhet nga dekani, zëvendësdekani, përgjegjësit e njësisë bazë dhe administratori i njësisë kryesore. Sipas nenit 41 të Statutit dhe në përputhje me kërkesat ligjore, dekani i fakultetit mban titullin “Profesor”. Neni 42 i Statutit përcakton funksionet dhe detyrat

kryesore të dekanit, ndër të cilat veçojmë: ai drejton dhe përfaqëson fakultetin, është anëtar i Senatit akademik, propozon drejtuesit e njësive bazë të fakultetit përkatës, emëron përgjegjësit e grupeve mësimore lëndore dhe ndërlyndore mbi propozimin e titullarit të njësisë bazë, kontrollon mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësitë bazë, në bazë të nevojave të fakultetit dhe zhvillimit të tij, i propozon rektorit vendet vakante dhe ndryshimet në numrin dhe pozicionet e burimeve njerëzore të fakultetit, për përgatitjen e procesit të rekrutimit; ngre komisionin ad-hoc të rekrutimit për fakultetin përkatës, etj.

Në bazë të nenit 45 të Statutit, përgjegjësi i departamentit dhe i qendrës kërkimore shkencore është autoriteti drejtues i njësisë bazë. Në përputhje dhe me kërkesat ligjore në fuqi, Statuti parashikon që këta drejtues të jenë “personel akademik i kategorisë “Profesor”” ose të ketë “gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor””.

Përveç Statutit, funksionimi i institucionit bazohet në Rregulloren Themelore të KU (*Evidenca Nr. 3 e DVV*), Rregulloren mbi Organizimin Akademik (*Evidenca Nr. 4 e DVV*), Rregulloren mbi Organizimin Administrativ (*Evidenca Nr. 5 e DVV*). Gjithashtu, institucioni ka dhe një Rregullore të Posaçme për Funksionimin e Studimeve dhe Provimeve të ciklit të dytë.

Vihet re një mospërputhje mes organigramës së institucionit (*miratuar si shtojca Nr. 2 e Statutit; Tabela 1 e Anekseve*) dhe nenit 3 të Rregullores Themelore: sipas organigramës institucioni ka vetëm një qendër (*Qendra studimore ndërdisiplinore për studime të paqes dhe dialogut*), ndërsa neni 3 i Rregullores Themelore dhe më pas neni 4 përmend Qendrën kërkimore-zhvillimore “Për shkencat islame” si dhe Qendrën kërkimore-zhvillimore “Për median dhe komunikimin”, të dyja në varësi të Fakultetit të Shkencave Humane. Megjithë mbivendosjet në përmbajtje midis këtyre rregulloreve, rregullimi i detajuar është një karakteristikë për t’u përshëndetur.


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Sipas të dhënave të administruara dhe sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në Institucion, Fakulteti i Shkencave Humane ka në përbërje të tij tre departamente: Departamentin e Drejtësisë, Departamentin e Shkencave Islame si dhe Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Secili nga departamentet përbëhet nga të paktën 7 anëtarë personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët minimumi 3 kanë grada shkencore ose tituj (*për më shumë shih tabelat 2 dhe 3 të Anekseve*). Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi një takim më Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Përgjegjës të Departamentit të Drejtësisë. Në bazë të informacionit mbi stafin akademik rezultoi se Dekani i Fakultetit është më titullin “Profesor i Asocuar”, pra në përmbushje të kërkesave të nenit 42 (3) të Ligjit për Arsimin e Lartë.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës (*Tabela 2 dhe 3 e Anekseve*)

Për vitin akademik **2013-2014**, Departamenti i Drejtësisë kishte në përbërje të tij **11 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 4 me gradën “Doktor”, 6 të nivelit Msc dhe **20**



anëtarë PAK prej të cilëve 5 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 me gradën “Doktor”, dhe 11 Msc.

Për vitin akademik **2014-2015**, Departamenti i Drejtësisë kishte në përbërje të tij **11 anëtarë PAE** prej të cilëve 5 me gradën “Doktor”, 6 Msc dhe **25 anëtarë PAK** prej të cilëve 5 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 6 me gradën “Doktor”, dhe 12 Msc.

Për vitin akademik **2015-2016**, Departamenti i Drejtësisë kishte në përbërje të tij **9 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 4 me gradën “Doktor”, si dhe 4 Msc dhe **23 anëtarë PAK** prej të cilëve 5 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 me gradën “Doktor”, dhe 12 Msc.

Për vitin akademik **2016-2017**, Departamenti i Drejtësisë kishte në përbërje të tij **8 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 3 me gradën “Doktor” dhe 4 Msc dhe **16 anëtarë PAK** prej të cilëve 3 me titullin “Profesor”, 3 me gradën “Doktor”, dhe 10 Msc.

Për vitin akademik **2017-2018**, Departamenti i Drejtësisë kishte në përbërje të tij **10 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 3 me gradën “Doktor”, 6 Msc dhe **15 anëtarë PAK** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 me gradën “Doktor” dhe 9 Msc.

Për vitin akademik **2018-2019**, Departamenti i Drejtësisë ka në përbërje të tij **9 anëtarë PAE** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 3 me gradën “Doktor”, 4 Msc dhe **11 anëtarë PAK** prej të cilëve 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i asociuar”, 3 me gradën “Doktor” dhe 6 Msc.

Në bazë të CV-ve të personelit të vëna në dispozicion nga institucioni (*Evidenca Nr. 40 e DVV*), rezulton se Përgjegjësi i Departamentit e ka marrë gradën shkencore “Doktor” pranë Akademisë së Mbrojtjes, pra jo në një nga universitetet e vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Megjithatë, kjo rrethanë lejohet nga neni 45(3) i Ligjit për Arsimin e Lartë, në rast se nuk ka kandidatë të tjerë për këtë detyrë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

– Praktikë e rekrutimit të stafit

Vlerësimi sipas Standardeve:

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IL2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Institucioni ka një strukturë organizative e cila ndihmon në përmbushjen e misionit të përcaktuar në nenin 4 të tij. Ai është i organizuar në dy Fakultete dhe Qendrën studimore ndërdisiplinore për studime të paqes dhe dialogut. Fakulteti i Shkencave Humane, i cili ofron programin e studimit në fjalë, është i organizuar në tre Departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Departamenti i Shkencave Islame.</p> <p>Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga IAL, nga viti akademik 2013 deri në vitin akademik 2019, Departamenti i Drejtësisë ka patur dhe vazhdon të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Drejtësisë janë njësitë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit në fjalë. Dekani i Fakultetit është autoriteti drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Ai ushtron funksione drejtuese, kontrolluese si dhe organizative si psh. emërimin e përgjegjësve të grupeve mësimore lëndore dhe ndërlëndore (<i>bazuar mbi propozimin e titullarit të njësisë bazë</i>), miratimin e komisioneve të provimeve të formimit, mbrojtjes së diplomave për programet e studimit dhe çdo komision tjetër në ndihmë të realizimit të detyrave dhe funksioneve të fakultetit. Përgjegjësi i departamentit, ndër të tjera, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin në njësinë bazë, evidenton nevojat për staf të ri akademik, merr pjesë në procesin e përzgjedhjes së kandidatave të stafit akademik, i propozon dekanit të fakultetit anëtarët e komisioneve të provimit të formimit apo edhe të mbrojtjes së diplomës për programet që mbulon njësi bazë e drejtuar prej tij.</p> <p>Si fakulteti dhe departamenti përfshihen në</p>

procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. Sipas nenit 46 të Statutit, nevojat për staf akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, evidentohen nga përgjegjësi i departamentit i cili ia përcjell më pas dekanit dhe rektorit. Në bazë të nenit 61 të Statutit dhe nenit 26 të rregullores themelore, kriteret e punësimit të stafit akademik përcaktohen nga njësia bazë (departamenti) pas pëlqimit të dekanit dhe miratimit të rektorit. Kjo procedure më pas i përcillet Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila publikon vendin bosh. Në vazhdim, komisioni ad-hoc i përbërë nga dekani i fakultetit, përgjegjësi i Departamentit përkatës, si dhe një anëtar i personelit akademik të njësisë bazë vlerëson përshtatshmërinë e kandidatëve me vendin e lirë të punës dhe bën renditjen e kandidaturave. Ky vendim i miratuar me shumicë të thjeshtë i paraqitet Rektorit i cili në fund bën emërimin me kohë të plotë të kandidatit. Në bazë të nenit 26 të rregullores themelore, përgjegjësi i burimeve njerëzore ndjek procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve pa të drejtë vote dhe në rast konstatimi të parregullsive në procedurë, përpilon relacionin përkatës drejtuar Rektorit. Në funksion të kësaj procedurë, institucioni ka hartuar dhe një dokument i cili përmban procedurën e punësimit të stafit (*Evidenca Nr. 17 e DVV*). Këto procedura u konfirmuan gjatë bisedës me përfaqësuesin e zyrës së burimeve njerëzore si dhe nëpërmjet evidencës shtesë "*Praktikë e rekrutimit të stafit*" të marrë në institucion gjatë vizitës.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Siç parashikohet dhe në ligj, KU "Bedër" ka në përbërje të tij së paku dy fakultete nga të cilët Fakulteti i Shkencave Humane përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Departamenti i Shkencave Islame. Gjatë gjithë periudhës së vlerësuar në këtë raport (2013-2019) Departamenti i Drejtësisë ka patur në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore "Doktor". Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane mban titullin "Profesor i Asocuar", në përputhje me nenin 42 i Ligjit për Arsimin e Lartë. Përgjegjësi i Departamentit mban gradën "Doktor".



2. Fakulteti dhe Departamenti me drejtuesit përkatës janë përgjegjës kryesorë për realizimin e programit të studimit. Gjithashtu ata përfshihen në procesin e rekrutimit të stafit akademik në bazë të rregullimeve të përcaktuara në Statutin e Institucionit dhe akteve të tjera të brendshme.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit


Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Departamenti i Drejtësisë i cili ofron Programin Master Shkencor në vite ka ndryshuar kompozimin e anëtarëve personel akademik efektiv (PAE) dhe anëtarëve personel akademik me kontratë (PAK). Numri i personelit efektiv PAE është luhatur midis numrit 6 deri në 11 (në vitin akademik 2017-2018), kurse personeli PAK në vite është luhatur midis numrit 4 deri në 13 (në vitin akademik 2015-2016) (*Tabela 5 e Anekseve*).

Raporti midis PAE dhe PAK të angazhuar në program ka qenë në disa vite i përmbysur në favor të PAK. Personeli i angazhuar zotëron grada e tituj, por programi ka dhe angazhim personeli në proces doktorature ose me diplomën Master i Shkencave. Pranë programit nuk rezultojnë të ketë angazhim personeli ndihmës mësimor. Në lidhje me kriteret e rekrutimit, kriteret dhe përshkrimi i punës për çdo pozicion janë përcaktuar në Rregulloren e Programeve të Ciklit të Dytë të Studimeve si dhe në Rregulloren e Institucionit, këto kritere bëhen pjesë e njoftimit për shpalljen e vendit të punës dhe zbërthehen edhe në aneksin e kontratës që lidhet më pas. Strategjia e Institucionit thekson objektivin e rekrutimit të personelit akademik që ka mbaruar studimet jashtë.

Nevoja për personel bashkë me kriteret përcaktohen në departament nga Përgjegjësi i Departamentit i cili ja përcjell kërkesën dekanit të Fakultetit i cili me aprovimin përkatës e përcjell tek Rektori i Institucionit. Rektori me miratim e përcjell pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila bën njoftimin përkatës dhe administron aplikimet bashkë me seleksionimin paraprak të përmbushjes së kritereve formale. Përzgjedhja bëhet nga një komision *ad hoc* i përbërë nga Dekani i Fakulteti, Përgjegjësi i Departamentit dhe 1 anëtar nga personeli i Departamentit, në cilësinë e relatorit, roli i të cilit në proces në raport me anëtarët e tjerë nuk është i qartësuar në Rregullore. Komisioni rendit tre kandidaturat e para dhe fituesi vendoset nga Rektori midis 3 vendeve të para, vendim i cili i përcillet zyrës së burimeve njerëzore dhe asaj të financës për dijeni dhe departamentit dhe fakultetit.



Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në lidhje me personelin akademik të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi, raporti midis personelit efektiv (PAE) dhe atij me kontratë (PAK) ka pësuar ndryshime në vite. (Shih Tabelën Nr. 5 të Aneksëve)

Sipas të dhënave nga ana e Institucionit, në vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet si vijon: **7 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 4 Dr/PhD. dhe 2 Msc. dhe **8 PAK** me kualifikimin: 3 Prof., 1 Dr/PhD. dhe 4 Msc. Raporti numerik paraqitet 7 / 8 ose 47 % / 53 %.

Në vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet si vijon: **7 PAE** me kualifikimin: 5 Dr/PhD. dhe 2 Msc. dhe **11 PAK** me kualifikimin: 2 Prof., 5 Dr/PhD. dhe 4 Msc. Raporti numerik paraqitet 7 / 11 ose 39 % / 61 %.

Në vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet si vijon: **9 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 4 Dr/PhD. dhe 4 Msc. dhe **13 PAK** me kualifikimin: 4 Prof., 2 Prof. As., 4 Dr/PhD. Raporti numerik paraqitet 9 / 13 ose 41 % / 59 %.

Në vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet si vijon: **6 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 3 Dr/PhD. dhe 2 Msc. dhe **7 PAK** me kualifikimin: 2 Prof., 4 Dr/PhD. Raporti numerik paraqitet 6 / 7 ose 46 % / 54 %.


Në vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet si vijon: **11 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 4 Dr/PhD. dhe 6 Msc. dhe **8 PAK** me kualifikimin: 1 Prof., 1 Prof.As., 4 Dr/PhD. dhe 2 Msc. Raporti numerik paraqitet 11 / 8 ose 58 % / 42 %.

Në vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet si vijon: **7 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 3 Dr/PhD. dhe 3 Msc. dhe **7 PAK** me kualifikimin: 1 Prof., 1 Prof.As., 3 Dr/PhD. dhe 2 Msc. Raporti numerik paraqitet 7 / 7 ose 50 % / 50 %.

Për të gjitha vitet akademike nuk ka raportim apo të dhëna në lidhje me personel ndihmës akademik pranë programit Master Shkencor në të dy drejtimet. Sipas dokumentit "Ngarkesa mësimore e pedagogëve 2016-2019, Msc Drejtësi, me profile", marrë nga vizita në Institucion, llogaritja e orëve për PAE dhe PAK dhe % e ngarkesës që mbulojnë, paraqitet si vijon:

- Viti akademik 2016-2017: PAE 1008 orë dhe PAK 308 orë, ose 76.6 % PAE / 23.4 % PAK;
- Viti akademik 2017-2018: PAE 1092 orë dhe PAK 280 orë, ose 79.6 % PAE / 20.4 % PAK;
- Viti akademik 2018-2019: PAE 784 orë dhe PAK 224 orë, ose 77.8 % PAE / 22.2 % PAK.

Për vitin akademik 2013-2014 në të 2 profilet nuk mund të arrihet në një analizë të saktë sepse programi i paraqitur përmban vetëm angazhimin e personelit akademik në një shtrirje lëndësh 1 vjeçare me 60 kredite dhe tezë; sipas shpjegimit nga ana e institucionit kjo për shkak të mos hapjes së programit në vitin paraardhës ose pasardhës; e njëjta situatë edhe për angazhimin e personelit në profilin "E drejtë ndërkombëtare" për vitin 2014-2015 ku angazhimi është paraqitur



për një program me 66 kredite në lëndë (me ofrim 2 herë të lëndës “Organizatet dhe Institucionet Ndërkombëtare”) plus teza, si dhe për të dy profilet në vitin 2018-2019. (Shih Tabelën 20 të Anekseve).

Në lidhje me kriteret e personelit akademik ka një problematikë në drejtim të angazhimit në program edhe të personelit akademik si të brendshëm e të jashtëm që ka vetëm gradën Master Shkencor. Kështu, në programin e çdo viti akademik në shqyrtim rezulton angazhim në nivelin e asistentëve të personelit akademik me Master Shkencor megjithëse në një numër të vogël në raport me angazhimin e lektorëve titullarë me grada e tituj. Gjithashtu, pranë programit nuk raportohet angazhim i personelit staf administrativ.

Sipas të dhënave të marra në institucion dhe analizës së rasteve të paraqitura, rekrutimi i personelit akademik ndjek kërkesat e Kodit të Punës në lidhje me njoftimin, fazat e procesit, vendimmarrjen dhe lidhjen e kontratës, etj. Statuti dhe rregullorja e punësimit parashikojnë rregulla të posaçme në lidhje me procesin e rekrutimit, përcaktimin e nevojave për personelin akademik dhe administrativ, rolin e njësisë, ngritjen e komisionit ad-hoc, rregullat e procesit, rolin e autoriteteve drejtuese në vendimmarrjen përfundimtare. Në drejtim të angazhimit të personelit të brendshëm akademik ndiqen parashikimet e Udhëzimit të ri Nr. 9, datë 10.09.2018 për ngarkesën. Rekrutimi i punonjësve të rinj bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në Statutin dhe në rregulloren e brendshme të institucionit. Përparësi i jepet personelit më të kualifikuar në tituj e grada dhe edukim në universitete të huaja.

Programi ka një komitet shkencor të programit të studimit me detyra organizative për programin e studimit përfshirë dhe përcaktimin e personelit me të cilin do të bashkëpunojë për realizimin e programit të studimit, strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve, dhe programin e kërkimeve, etj. Komiteti është i përbërë nga 3 anëtarë me gradën Dr ose PHD. (Shih Tabelën Nr. 4 të Anekseve)


Të dhëna të plota në lidhje me moshën, gradat e titujt sipas kategorive, janë pasqyruar në Tabelat 6, 7 dhe 8 në Anekset e Raportit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Plani mësimor i lidhur me stafin akademik, i ndarë sipas viteve akademike (përfshirë tek tabelat në word)
- Kontratë I.P (pranverë 2015)
- Kontratë I.P (pranverë 2016)
- Model procedure rekrutimi Faculty Selection Committee Meeting
- Faculty Selection Criterias and Procedures

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	



<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Mund të thuhet se angazhimi i personelit akademik të institucionit bëhet përgjithësisht në përputhje me objektivat e programit. Nuk rezultojnë të ketë personel ndihmës mësimor-shkencor të angazhuar në program. Një raport më i mirë duhet ndërtuar në drejtim të përputhjes midis objektivit të studimit të lëndëve dhe ekspertizës/fushës së përgatitjes së personelit akademik. Për shembull, megjithë afërsinë e fiushave të studimeve, lënda “Tema specifike në drejtësi” (me fokus BE, mbrojtja e konsumatorit, markat tregtare, tregtia elektronike, ligji i internetit etj) apo lëndët “Marrëdhëniet juridike me jashtë në çështjet penale”, “The law of treaties”, “International human rights law”, “European Union law”, “Public international law”, “International investment Law”, “Procedurë penale e avancuar me praktikë gjyqësore”, etj., jepen nga lektorët të kualifikuar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërkohë që fokus i këtyre lëndëve sipas përshkrimit në programet e këtyre lëndëve është e drejta; ose lektorët jashtë ekspertizës së posaçme të tyre që evidentohet nga natyra e kërkimit shkencor dhe publikimeve të tyre si dhe CV-përkatëse të paraqitura pra jo në fushën e së drejtës. Disa nga këto lëndë kanë dhe një asistent të nivelit master shkencor apo LLM.</p> <p>Sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi, angazhimi i personelit akademik në nivelin Master Shkencor duhet të lidhet me kualifikimin Doktor i Shkencave e sipër. Programi ka përgjithësisht një angazhim të përshtatshëm, me angazhimin në nivelin e titullarëve të personelit akademik me kualifikimin Dr e sipër. Në nivelin e asistentit ka angazhim në një numër të vogël edhe të personelit me kualifikim Msc.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të</p>	<p>Në konsultim me rregullat e Statutit dhe rregulloren e programit rezultojnë se përgjegjësia kryesore në hartimin e kurrikulës i përket</p>

David R. R. R.

[Signature]

programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

personelit akademik të njësisë bazë. Sipas rregullores së institucionit, neni 25 parashikon se personeli akademik gëzon liri të plotë akademike në drejtim të mësimdhënies, punës kërkimore-shkencore, kontributit institucional dhe kontributit profesional.

Sidoqoftë, në Statut dhe në Rregulloren e Institucionit ka parashikime për kompetencat e drejtuesit të Departamentit por mungojnë parashikimet për rolin dhe detyrat e Departamentit si njësi akademike e shkencore përgjegjëse për programet që ofron.

Kështu në nenin 21 parashikohen detyrat e Drejtuesit të Departamentit në drejtimin e hartimit të kurrikulave për të gjitha ciklet e studimeve të lëndëve që mbulon departamenti, planeve mësimore dhe zbatimin e tyre, mbikqyrjen e veprimtarisë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mbajtjen e dokumentacionit e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij, respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar dhe veprimtarive të tjera të procesit mësimor, miratimin e modalitetet e vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti, paraqitjen e kritereve të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, pas diskutimit paraprak në departament, për miratim tek rektori, pas pëlqimit të dekanit përkatës, etj. Sipas këtij neni përgjegjësi i departamentit në veprimtarinë e tij mbështetet në mendimin e personelit akademik të departamentit.

Ndërkohë në një Rregullore tjetër, atë të Organizimit Akademik, në nenin 14 rregullohet Departamenti dhe disa kompetenca të tij, e më tej në nenin 17 rregullohet Këshilli i departamentit që në përkufizimin që përmban neni përfshin të gjithë anëtarët e departamentit, pra praktikisht realizon përfaqësimin e vetë

Departamentit. Mund të thuhet së këshilli i departamentit ka rregullim të përshtatshëm në drejtim të kompetencave që duhet të ketë si organ kolegjal, sidoqoftë referenca dhe rregullimi i kompetencave tek Departamenti do të ishte më i përshtatshëm, duke evituar mbivendosjet.

Kompetenca për Departamentin gjendet edhe në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë në nenin 7 të së cilës parashikohet se çdo departament zgjedh Komitetin shkencor për çdo program studimi të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti shkencor mban përgjegjësinë organizative për programin përkatës të ciklit të dytë. Komiteti shkencor përcakton, gjithashtu, personelin tjetër akademik dhe ndihmës, me të cilin do të bashkëpunojë për realizimin e programit të studimit, përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve, dhe programin e kërkimeve, përgatit çdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë. Në sa më sipër duhet harmonizuar rregullorja e institucionit me Rregulloren e programeve të ciklit të dytë të studimeve në drejtim të kompetencave të departamentit.


Ndërkohë janë parashikuar disa nivele koordinimi në lidhje me programin e ciklit të dytë të studimeve: Koordinatori i përgjithshëm i programeve të ciklit të dytë që emërohet nga Senati akademik; Koordinatorët e programeve të ciklit të dytë që bashkërendojnë punën e të gjitha programeve të ciklit të dytë brenda IAL-së, të zgjedhur nga Komiteti shkencor (në mungesë të tij ky funksion i ngarkohet përgjegjësit të departamentit); Koordinatori i programit me detyra pranë departamentit si propozime ndaj këshillit të departamentit në lidhje me planifikimet e personelit akademik, për t'u miratuar më pas nga Dekanati i



Fakultetit dhe nga Senati akademik, raportim tek bashkërenduesit e programeve të ciklit të dytë për mbarëvajtjen e programit përkatës, ndjekjen e mbarëvajtjes së punës kërkimore të studentëve të programit përkatës. Më tej në nenin 11 të Rregullores së studimeve të ciklit të dytë janë rregulluar detyrat e Koordinatorit të departamentit për programet e ciklit të dytë që është njëherësh edhe sekretar i programit të studimit të ciklit të dytë me detyra sekretarike si komunikimin shkresor me organet e tjera të strukturës së brendshme të Kolegjit Universitar, me departamentet përkatëse, personelin akademik, studentët dhe me bashkëpunëtorët e institucionit, mbajtjen e arkivës së dokumentacionit të programeve të studimit të ciklit të dytë, materialet e pedagogëve dhe të studentëve, ndjek ecurinë e procesit mësimor në lidhje me strukturën mësimore, orarin e lëndës e të provimeve, ecurinë e praktikës dhe mban dokumentacionin përkatës të këtyre proceseve. Në sa më sipër është e nevojshme të qartësohen kompetencat midis koordinatorëve, të lehtësohet struktura në drejtim të një ndarje detyrash efikase pa mbivendosje.

Punësimi në Kolegjin Universitar “Bedër” bëhet bazuar në legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore e nënligjore të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe Statutin e institucionit. Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, bazuar në kërkesat e Statutit të Institucionit. Po kështu sipas nenit 78 të Rregullores së Institucionit përcaktimi i ngarkesës së lëndës/veprimtarisë formuese dhe dhënia e kreditit ECTS për atë lëndë/veprimtari formuese është përgjegjësi e stafit akademik të departamentit përkatës që jep lëndën/veprimtarinë formuese në fjalë sipas fushave të departamenteve por nuk ka parashikime se cili është roli i departamentit në këtë proces.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe



vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.


Rekrutimi i personelit akademik rregullohet në drejtim të procedurave për rekrutim në Rregulloren e institucionit, nenet 26-27 dhe në Rregulloren e rekrutimit. Nga takimi me stafin dhe konsultimi i dokumentacionit, përparësi i jepet personelit të kualifikuar sidomos në universitete të huaja.. Përzgjedhja bëhet nga një komision *ad hoc* i përbërë nga Dekani i Fakulteti, Përgjegjësi i Departamentit dhe 1 anëtar nga personeli i Departamentit, në cilësinë e relatorit, roli i të cilit në proces në raport me anëtarët e tjerë nuk është i qartësuar në Rregullore. Komisioni rendit tre kandidaturat e para dhe fituesi vendoset nga Rektori midis 3 vendeve të para; vlen të ndryshohet ky rregull në drejtim të vlerësimit të procesit të rekrutimit e rankimit të zhvilluar nga ana e Komisionit në linjë dhe me parimet e përgjithshme të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kodit të Punës.

Për të gjitha vitet akademike nuk ka raportim apo të dhëna në lidhje me personel ndihmës akademik pranë programit Master Shkencor në të dy drejtimet. Sipas të dhënave të Institucionit, në vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet: **7 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 4 Dr/PhD. dhe 2 Msc. dhe **8 PAK** me kualifikimin: 3 Prof., 1 Dr/PhD. Dhe 4 Msc. Raporti numerik paraqitet 7 / 8 ose 47 % / 53 %.


Në vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet: **7 PAE** me kualifikimin: 5 Dr/PhD. dhe 2 Msc. dhe **11 PAK** me kualifikimin: 2 Prof., 5 Dr/PhD. dhe 4 Msc. Raporti numerik paraqitet 7 / 11 ose 39 % / 61 %.

Në vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet: **9 PAE** me kualifikimin: 1 Prof., 4 Dr/PhD. dhe 4 Msc. dhe **13 PAK** me kualifikimin: 4 Prof., 2 Prof. As., 4 Dr/PhD. Raporti numerik paraqitet 9 / 13 ose 41 % / 59 %.

	<p>%.</p> <p>Në vitin akademik 2016-2017 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet: 6 PAE me kualifikimin: 1 Prof., 3 Dr/PhD. dhe 2 Msc. dhe 7 PAK me kualifikimin: 2 Prof., 4 Dr/PhD. Raporti numerik paraqitet 6 / 7 ose 46 % / 54 %.</p> <p>Në vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet: 11 PAE me kualifikimin: 1 Prof., 4 Dr/PhD. dhe 6 Msc. dhe 8 PAK me kualifikimin: 1 Prof., 1 Prof.As., 4 Dr/PhD. dhe 2 Msc. Raporti numerik paraqitet 11 / 8 ose 58 % / 42 %.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi paraqitet: 7 PAE me kualifikimin: 1 Prof., 3 Dr/PhD. dhe 3 Msc. dhe 7 PAK me kualifikimin: 1 Prof., 1 Prof.As., 3 Dr/PhD. dhe 2 Msc. Raporti numerik paraqitet 7 / 7 ose 50 % / 50 %.</p> <p>Sipas dokumentit “<i>Ngarkesa mësimore e pedagogëve 2016-2019, Msc Drejtësi me profile</i>”, marrë nga vizita në Institucion, llogaritja e orëve për PAE dhe PAK dhe % e ngarkeses që mbulojnë paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2016-2017: PAE 1008 orë dhe PAK 308 orë, ose 76.6 % PAE / 23.4 % PAK; - Viti akademik 2017-2018: PAE 1092 orë dhe PAK 280 orë, ose 79.6 % PAE / 20.4 % PAK; - Viti akademik 2018-2019: PAE 784 orë dhe PAK 224 orë, ose 77.8 % PAE / 22.2 % PAK. <p>Për vitin akademik 2013-2014 në të 2 profilet nuk mund të arrihet në një analizë të saktë sepse programi i paraqitur përmban vetëm angazhimin e personelit akademik në një shtrirje lëndësh 1 vjeçare me 60 kredite dhe tezë; sipas shpjegimit nga ana e institucionit kjo për shkak të mos hapjes së programit në vitin paraardhës ose pasardhës; e njëjta situatë edhe për angazhimin e personelit në profilin “E drejtë ndërkombëtare” për vitin 2014-2015 ku angazhimi është</p>
--	---




	<p>paraqitur për një program me 66 kredite në lëndë (me ofrim 2 herë të lëndës “Organizatat dhe Institucionet Ndërkombëtare”) plus teza, si dhe për të dy profilet në vitin 2018-2019. Nuk është e qartë si ndahet ngarkesa dhe përgjegjësia midis personelit të brendshëm dhe atij të jashtëm në tematikën e lëndës.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka një sistem procedurash të përshtatshme për vlerësimin e personelit; vlerësimi realizohet në disa nivele, nga studentët në përfundim të programit të studimit përpara zhvillimit të provimit dhe nga departamenti në një vlerësim periodik të anëtarëve të personelit akademik. Rubrikat e formularëve përfshijnë disa aspekte si mësimdhënia, kërkimi shkencor, apo kontributi institucional, në projekte, etj.</p> <p>Institucioni mban një bazë të përshtatshme të të dhënave të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. ose postuniversitare jashtë vendit. Institucioni publikon vendet vakante dhe kriteret përkatëse në web site.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në</p>	<p>Përgjegjësi i programit Master Shkencor ka gradën Doktor i Shkencave nga një Institucion vendas kurse Dekani mban titullin Prof. Asoc. Ndërkohë sipas akteve të institucionit, në rregulloren e programeve të ciklit të dytë është përcaktuar qartë se personeli akademik, që zhvillon mësim në programet e studimit të ciklit të dytë, përbëhet nga personeli akademik që mban, të paktën, gradën shkencore “Doktor”. Në programin në vlerësim titullarët janë të gjithë të kualifikimit Doktor i Shkencave e sipër. <i>(Të dhënat për çdo vit ndodhen në Tabelën 20 të Anekseve).</i></p> <p>Rektori, Zv/rektori, drejtori dhe Zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, Dekani, Zv/dekani, Drejtori, Përgjegjësi i Departamentit, Koordinatorja e programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve. Në drejtim të praktikave</p>




<p>institucionin që ofron programin e studimeve; Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>profesionale, programi Master nuk ka praktikë.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli; Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor"; Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit në institucion por edhe nga informacioni i përcjellë nga ana e studentëve mund të thuhet se studentët që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në të dyja profilet kanë udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve. Identifikimi i udhëheqësit bëhet në vitin e dytë të studimeve dhe udhëheqësit e konsultuar i përkasin personelit që zotëron gradën shkencore "Doktor" dhe Prof. Asoc. Gjithashtu, sipas Rregullores së programit studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe po sipas Rregullores, udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Në vlerësim të të dhënave të mbledhura në takime e listës së pedagogëve në drejtim të tezës mund të thuhet se angazhimi i udhëheqësve bëhet në vlerësim të fushës së tyre studimore-kërkimore dhe ekspertizës së nevojshme respektivisht për fushën në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga të dhënat e paraqitura nga Institucioni, nuk rezultojnë të ketë angazhim personeli ndihmës mësimor-shkencor në programin Master Shkencor në Drejtësi në të 2 profilet.</p> <p>Sidoqoftë, në aktivitete të tilla si kërkim burimesh nëpërmjet sistemit online të bibliotekës, angazhimi nga ana e personelit të bibliotekës dhe stafit administrativ të institucionit ishte i dukshëm.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Sipas informacionit të marrë në institucion e në konsultim me kontratat e punës rezultojnë që në lidhje si me personelin akademik të brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm ndiqen rregullime sipas rregullimeve të Udhëzimit Nr. 20, i datës 09.05.2008 i Ministrisë të Arsimit. Sipas komunikimeve të përfaqësuesve të Institucionit me GVJ gjatë vizitës në Institucion kjo qasje do të vazhdojë edhe në vitet në vijim bazuar edhe në Udhëzimin e ri Nr. 9, datë 10.09.2018, i cili megjithëse në pikën 5 të tij parashikon të drejtën e IAL jo publike për përcaktimin e ngarkesës minimale nga vetë institucioni, është zgjedhur të jetë i zbatueshëm edhe në institucion. Sipas Rregullores së Institucionit nenit 27 koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1536 orë në vit.</p> <p>Stafi i brendshëm sipas komunikimeve me anëtarët e personelit akademik dhe konsultimit të kontratave përkatëse qëndron minimalisht në limitin e 240 orëve mësimore në auditor, dhe aktivitete të tjera mbi këtë ngarkesë, kurse personeli i jashtëm sipas orëve të vendosura në kontratë. Në konsultim me aktet e institucionit dhe komunikimet me lektorët e programit rezultojnë një angazhim në auditor në masën 20 orë në javë.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

Janina Kary

[Signature]

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p>Institucioni disponon bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Gjithashtu, disponohet për secilin semestër lista e plotë e personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ. Në drejtim të kriterëve dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, ato janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren për Rekrutimin e Personelit Akademik. Thirrjet janë publike në përmbushje të kërkesave të kuadrit ligjor në fushën e arsimit të lartë dhe kërkesave të Kodit të Punës.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p>	
<p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Mund të thuhet se angazhimi i personelit akademik të institucionit bëhet përgjithësisht në përputhje me objektivat e programit të studimit. Megjithatë, duhet rishikuar përputhja midis natyrës së lëndëve dhe ekspertizes/fushës së përgatitjes së personelit akademik të cilat mund të ndikojnë në përmbushjen e objektivave të lëndës si dhe trajtimin të çështjeve në thellësinë e kërkuar nga studimet e avancuara në nivelin e masterit shkencor. Programi ka përgjithësisht një angazhim të përshtatshëm, me anagazhimin në nivelin e titullarëve të personelit akademik me kualifikimin Dr e sipër. Në nivelin e asistentit ka angazhim në një numër të vogël edhe të personelit me kualifikim Msc.
2. Ngarkesa mësimore e PAE në raport me PAK sipas të dhënave nga institucioni për periudhën 2016-2019 është në linjë me kërkesën e mbulimit 70% të ngarkesës nga PAE.
3. Institucioni disponon bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.
4. Në aktet e Institucionit është parashikuar Departamenti dhe Këshilli i departamentit që përfshin të gjithë anëtarët e departamentit. Këshilli i departamentit ka rregullim të përshtatshëm në drejtim të kompetencave; sidoqoftë referenca dhe rregullimi i kompetencave tek Departamenti si njësi akademike e shkencore do të ishte më përshtatshëm e do të evitonte mbivendosjen.
5. Në drejtim të procesve të rekrutimit ato bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në Statutin dhe në rregulloren e brendshme të institucionit; vlen të ndryshohet rregulli i përzgjedhjes së fituesit nga Rektori midis 3 vendeve të para në linjë me parimet e përgjithshme të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kodit të Punës.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore




Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe pas vizitës në institucion, rezulton se institucioni e zhvillon veprimtarinë në dy godina të marra me qera. Institucioni ka paraqitur si evidencë kontratën e qerasë sipas së cilës institucioni ka marrë me qera objektin C, katin 0 dhe katin -1 me sipërfaqe 6430 m² (*Evidenca Nr. 33 e DVV*). RVB përmend godinën A me 8 kate dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme 3957 m² dhe godinën B me 2 kate me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 1671 m². Këto dy godina nuk rezultojnë në kontratën e paraqitur nga institucioni si evidencë. Për më tepër kjo kontratë është e firmosur nga qeramarrësi dhe qeradhënësi, por nuk përmban detajet e një akti noterial si data, nr. Rep dhe nr. Kol. Gjithashtu, RVB përmend që godinat janë kontraktuar me qera për një periudhë 10 vjeçare (shih fq. 49), ndërkohë që kontrata e paraqitur si evidencë i referohet një periudhe 5 vjeçare duke filluar nga data 01.09.2017. Pavarësisht këtyre mospërputhjeve apo paqartësive, nga vizita në institucion u vu re se institucioni ofron hapësira të bollshme, nje bibliotekë, salla mbledhjesh, klasa etj. (*shih gjithashtu evidenca Nr. 46 "Planimetria e godinës aktuale" dhe evidenca Nr. 47 "Ambientet e KUB"*) Gjithashtu, gjatë bisedës në institucion GVJ u informua se institucioni zotëron një hapësirë truall në Sauk ku po ndërtohet kampusi i ri (*shih "Projekti aktual i kampusit, evidenca Nr. 30*)


Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (*Tabela 9 e Anekseve*)

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin: (*Tabela 9 e Anekseve*)

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore



- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën e cila është ngritur në nivel institucional dhe ndodhet në katin e parë të godinës kryesore. Sipas RVB, ajo numëron rreth 36000 libra dhe një ambjent prej 230 m². Sipas informacionit në faqen e internetit të institucionit, biblioteka qëndron e hapur çdo ditë për studentët në këto orare: 08.00 - 12.00 dhe nga 01.00 - 17.00. Me kërkesë të GVJ, institucioni vuri në dispozicion listën e titujve në gjendje në bibliotekë lidhur me programin e Drejtësisë (*shih dokumentacion shtesë "Fondi fizik i bibliotekës në lidhje me drejtësinë dhe specifikisht për programin Msc. në Drejtësi"*). Nga shqyrtimi i listës së librave si dhe nga kërkimi në faqen e internetit të bibliotekës (<http://library.beder.edu.al/>), vihet re se Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik titujt kryesorë të së drejtës kombëtare, ndërkombëtare dhe europiane.

Megjithatë, lidhur me fondin fizik të bibliotekës vihet re se titujt e vënë në dispozicion nuk janë botimet më të fundit në fushën përkatëse. Për shembull, nga një kërkim më togfjalëshin "international law" rezultojnë 12 tekste, më i riu nga të cilët është "Research handbook on the theory and history of international law" botuar nga Edward Elgar dhe daton në vitin 2011. Si një shembull tjetër të nevojës së përditësimit të fondit të bibliotekës, sjellim librin nga Malcolm D. Evans "Blackstone's International Law Documents" botim i Oxford University Press i cili është i vitit 2009, ndërkohë që botimi më i ri i takon vitit 2017. Në mënyrë të ngjashme, libri "EU Law: Text, Cases, and Materials" nga Paul Craig dhe Grainne de Burca që gjendet në bibliotekë është botim i vitit 2011 ndërkohë që i njëjti libër është ribotuar në vitin 2015. Sa i takon fushës së të drejtës penale, nga një kërkim me fjalën "criminal" dalin 15 rezultate ndër të cilat "The Oxford companion to international criminal justice"(2009); William Schabas, "Introduction to the International Criminal Court" (2011); European criminal law Corstens (2002); Erik Claes, Antony Duff and Serge Gutwirth, "Privacy and the Criminal Law" (2006); Jean Pradel and Geert Corstens, "European Criminal Law" (2002); Andre Klip, "European Criminal Law: An Integrative Approach" (2012); Estella Baker, "Taking European Criminal Law Seriously" (Criminal Law Review 1998); Richard N Kocsis, "Applied Criminal Psychology: A Guide to Forensic Behavioral Sciences" (2009); Francis Pakes, "Comparative Criminal Justice" (2010); H Dammer and E Fairchild, "Comparative Criminal Justice Systems" (2006); Jacinta Gau, "Statistics for Criminology and Criminal Justice" (2013); Kevin John Heller and Markus Dubber (eds), "Comparative Criminal Law" (2011); Carl Constantin Lauterëien, "The limits of criminal Law, a comparative analysis of approaches to legal theorizing" (2010). Siç shihet dhe nga këto rezultate të kërkimit teksti më i ri në të drejtë penale në gjuhën angleze i takon vitit 2013.

Gjithashtu, titujt e mëposhtëm të cilët përbëjnë literaturë të detyrueshme për disa nga lëndët e programit master nuk gjenden në fondin bibliotekën e institucionit.

Lënda: Metoda Kërkimore

Bryman, 2012

Rabbie, 2012

Volokh, 2010

Lënda: History and Theory of international law

History of International Law Foundations and principles of international law Sources of International law, Law of Treaties 1981

Lënda: Tema specifike në drejtësi

Krimi i organizuar transnacional

Lënda: Law, Reconciliation and Reconstruction of Post-conflict society

Kerr, 2004

Veuthey, 2013

Beruto, 2006

Stromseth, 2009

International Human Rights Law

Alston et al (viti i botimit?/mungojne referencat e plota)

Lënda: European Union Law

Jones and Sufrin, 2014

Lenaerts and Van Nuffel, 2011

Organizatrat dhe institucionet ndërkombëtare

Leci, 2011

Lënda: The Law of Armed Conflicts


Kolb and Hyde 2008

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Fondi fizik i bibliotekës në lidhje me drejtësinë dhe specifikisht për programin Msc. në Drejtësi

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Institucioni zhvillon aktivitetin e tij në dy ndërtesa ku ndodhen zyrat qendrore administrative si dhe ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se institucioni ka një kontratë qeraje për godinën C me kohëzgjatje 5 vjet më të drejtë zgjatjeje ose ripërtëritjeje pas këtij afati. Institucioni garanton mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura për të përmbushur nevojat e mësimdhënies. Gjatë takimit në institucion GVJ u informua për planin e ndërtimit të një kampusi të ri ku do të përmbledhet e gjithë veprimtaria administrative dhe e mësimdhënies së institucionit.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë,	

shkencave teknike, etj.	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën e cila përmban titujt kryesorë të së drejtës kombëtarë, ndërkombëtare dhe europiane. Në përgjithësi, literatura e ofruar në bibliotekë është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat më themelore të studimit dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, fondi i bibliotekës duhet përditësuar si dhe institucioni duhet të sigurojë që materialet e detyrueshme në lëndë të caktuara gjenden në bibliotekë.</p> <p>Institucioni ka hartuar “Planin Strategjik Institucional” për vitin 2018-2023 i cili përmban, ndër të tjera, si pjesë të objektivave strategjike dhe përditësimin e bibliotekës “sipas fushave përkatëse, si dhe stimulimi(n) i(e) studentëve në përdorimin e bibliotekës online.” Megjithatë, përtej këtij objekti nuk ka evidencë të një plani të detajuar për shtimin e materialeve në bibliotekë. Biblioteka është e hapur për studentët çdo ditë nga ora 08.00 deri në 12.00 dhe nga 13:00 - 17.00 duke i shërbyer studentëve për programin e studimit.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Infrastruktura e institucionit në përgjithësi lejon për një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimor. Institucioni vë në dispozicion të studentëve klasa, salla leksioni, bibliotekën si dhe zyra për stafin administrativ.</p> <p>Mjediset mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies në të gjitha format e saj, mbështetur edhe nga teknologjia.</p>




Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ hapësira të mjaftueshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe asaj administrative. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se godina aktuale është marrë më qera nga institucioni për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë zgjatjeje osse ripërtëritjeje pas këtij afati.
2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën e cilë përgjithësisht plotëson nevojat themelore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, është i nevojshëm një përditësim i titujve në bibliotekë me qëllim që të reflektohet debati akademik bashkëkohor si dhe të sigurohet që literatura e detyrueshme për lëndët e programit të jetë e pranishme në bibliotekë.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas neneve 93-94 të Satutit të Kolegjit Universitar "Bedër", Kolegji financohet nga kapitali i themeluesit dhe pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij, të ardhura të krijuara, donacione, burime të tjera të ligjshme. Në të ardhurat e Kolegjit përfshihen a. tarifat e studimeve; b. të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, sipas marrëveshjeve të lidhura; c. të ardhura nga shërbimet në fushën e botimeve, prodhimit të dokumentarëve, kërkimeve të ndryshme me interes komunitar etj.; d. të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara; e. të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim të palëve të treta në trajtën e kontratave të qeradhënies dhe me forma të tjera kontraktimi; f. dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike dhe private; g. të ardhura që krijohen nga organizimi i konferencave, workshopeve, konsulencave profesionale etj.; h. financime të tjera të ligjshme.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, në të gjitha vitet në analizë, burimet kryesore të të ardhurave të tij janë kryesisht tarifat për dhe gjatë shkollimit, donacionet, konsulencat e shërbimet e më pak grantet për kërkim shkencor dhe kontrata. Të dhëna të detajuara ndodhen në tabelat në fund të Raportit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (**në përqindje**):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit



- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Të ardhurat dhe financimet në vitet në shqyrtim rezultojnë të jenë rreth 60% nga tarifat e studentëve, pjesa tjetër rreth 40% nga donacionet dhe më pak në 2 vite janë siguruar të ardhura nga grante kërkimi dhe kontrata. Të dhëna të plota gjenden në *Tabelën 10 të Anekseve*. Viti 2018-2019 përfshin shpenzimet e kryera deri me datë 11 dhjetor 2018.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje):

Në lidhje me shpenzimet sipas të dhënave në vite, mund të thuhet se rreth 50-60% e të ardhurave shkojnë për paga e sigurime për personelin e Institucionit kurse pjesa tjetër shpenzime operative. Në vitin 2017-2018 përfshihet edhe një investim në shpenzime. Të dhëna të plota janë pasqyruar në *Tabelën 11 të Anekseve*.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Kolegji ka miratuar një Rregullore në lidhje me mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat. Sipas nenit 95 të Statutit, Projektbuxheti njëvjeçar i Kolegjit hartohet çdo fillim viti akademik nga Administratori, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse, si dhe miratohet nga Senati Akademik, pasi miratohet nga Bordi i Administrimit. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga kuadri ligjor në fuqi. Sipas nenit 96 të Statutit, kontrolli dhe auditimi i jashtëm i Kolegjit kryhet nga auditues të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin, nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave dhe kundrejt tarifave të miratuara nga Ministria e Financave. Në konsultimet në Institucion, raportet e auditit përmbajnë të dhëna mbi situatën financiare për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë, grantet e</p>

	përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura; raportet gjithashtu analizojnë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve, etj.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të konsultuar Institucioni përpilon raporte të përvitshme financiare dhe në kushtet aktuale mund të thuhet se reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron për mbështetjen e programit të studimit Master Shkencor. Perspektiva është e lidhur me numrin e studentëve që do ta zgjedhin Institucionin për të vijuar studimet Master në dy profilet përkatëse.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kolegji ka miratuar një Rregullore në lidhje me mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat. 2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm i Kolegjit kryhet nga auditues të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin, nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave dhe kundrejt tarifave të miratuara nga Ministria e Financave. 3. Raportet analizojnë eficiencën e përdorimit të të ardhurave në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve. Perspektiva është e lidhur me numrin e studentëve që do ta zgjedhin Institucionin për të vijuar studimet Master. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë përfshin *Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit* (Komisioni) si dhe *Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë* (Njësia). Në bazë të nenit 8 të Statutit, Komisioni dhe Njësia janë organe drejtuese të institucionit. Në bazë të nenit 12 të Statutit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të pare propozon komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Në bazë të nenit 14 të Rregullores Themelore “Komisioni i përhershëm për garantimin e cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit ngrihet me vendim të Senatit Akademik dhe ka në përbërje: i. Të paktën tre anëtarë të Senatit

Akademik; ii. Një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve; iii. Një ekspert i jashtëm". Institucioni gjithashtu ka hartuar "Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë" (*shih evidenca 8 e DVV*). Në bazë të nenit 6 të kësaj rregulloreje "Njësitia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) kryetar, 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët e njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit". (*Për përbërjen e tij shih Tabelën 12 të Anekseve*). Siç dhe rezultoi nga biseda në institucion, ndarja e kompetencave midis Komisionit dhe Njësisë është pak e vështirë, megjithatë Komisioni ka më shumë kompetenca politikëbërëse ndërsa njësitia merret me zbatimin e këtyre politikave.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati një takim me Kryetarin e NJSBC dhe ekspertin e jashtëm. Gjithashtu, si Komisioni dhe Njësitia veprojnë mbi bazën e rregulloreve përkatëse (*shih respektivisht evidenca nr. 20 dhe evidenca nr. 8 e DVV*.) Në mënyrë të përmbledhur, Njësitia është përgjegjëse për mbështetjen e Komisionit në hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, për vlerësimin në mënyrë periodike të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, për vlerësimin e ecurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit, për ndjekjen e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, për organizimin e pyetësorit studentor në fund të çdo semestri, si dhe për raportimin para Senatit Akademik lidhur me rezultatet dhe propozimet përkatëse (*shih nenin 10 të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e NJSBC si dhe fq. 58-59 të RVB*).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit:

Një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së NJSBC janë vlerësimet nga studentët. Këto vlerësime kryhen në mënyrë periodike në fund të çdo semestri. Ky fakt u konfirmua gjatë takimit me përfaqësuesit e Komisionit si dhe nga takimi me studentët të cilët pohuan se vlerësimi i lëndës ndodh në fund të çdo semestri dhe organizohet në mënyrë anonime. Për këtë qëllim, institucioni ka hartuar dhe Rregulloren e Anketave dhe Vlerësimeve (*shih evidencën nr. 9*) si dhe Rregulloren për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik (*shih evidencën nr. 23*). Sipas RVB (fq. 59) gjatë periudhës gjashtë vjeçare objekt i këtij riakreditimi janë zhvilluar 12 anketime të tilla me studentë. Megjithatë nuk ka të dhëna specifike lidhur me numrin e përgjithshëm të studentëve të anketuar, përpunimin e të dhënave të dala nga këto anketime si dhe hapat e mëtejshëm të ndërmarrë nga njësitë përkatëse.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Sipas nenit 2 të Rregullores së Anketave dhe Vlerësimeve, përveç anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, institucioni realizon dhe anketat e mëposhtme:

- 1) anketën vetëvlerësuese të stafit akademik;
- 2) anketën e vlerësimit të stafit akademik ndaj institucionit;
- 3) anketën e vlerësimit të stafit administrativ ndaj institucionit;

4) anketën e vlerësimit të studentit ndaj institucionit.



Anketa vetëvlerësuese e stafit akademik ka për qëllim vetëvlerësimin e performancës së stafit akademik nëpërmjet njohjes së progresit “që ka pasur stafi akademik gjatë vitit të kaluar”, përcaktimit të mënyrave “nëpërmjet të cilave performanca e tyre mund të përmirësohet dhe zhvillohet për t’i shërbyer si individit edhe institucionit”, mbështetjes dhe zhvillimit të qëllimeve për vitin e ardhshëm akademik, rishikimin e karrierës, përcaktimin e fushave të trajnimit dhe të treguesve të cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe publikime (*shih nenin 3 të Rregullores së Anketave*). Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ një shembull të tillë ankete. Neni 3 i Rregullores së Anketave parashikon një procedurë të detajuar të hapave që ndërmerren nga vlerësuesi dhe i vlerësuarit lidhur me procesin e vetëvlerësimit.

Siç është përmendur dhe më lart, Komisioni dhe Njësia bazohen në rregulloret përkatëse të cilat përmbajnë funksionet dhe detyrat kryesore të këtyre organve. Megjithatë, në morinë e dokumentacionit rregullues të Komisionit dhe Njesisë mungon një plan veprimi i detajuar në kohë i cili përfshin organet përgjegjës dhe hapat që duhen ndjekur në rast se raportet evidentojnë probleme. Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi evidencë të këtij plan veprimi të aktivitetit të Komisionit ose Njesisë. Në përgjigje, institucioni depozitoi dokumentin shtesë “Plan veprimi për objektivat e kërkimit shkencor integrimin e studentëve dhe stafit të huaj hartuar nga KP” i cili përcakton hapat konkrete për t’u ndjekur nga Komisioni dhe Njësia lidhur me monitorimin e aktivitetit dhe rezultateve të kërkimit shkencor. Si tregues të matshëm në këtë plan identifikohet vlerësimi i konferencave periodike shkencore të institucionit, vlerësimi i veprimtarisë shkencore të stafit akademik, vlerësimi i projekteve kërkimore-shkencore etj. Në vijim të këtij plani, nuk ka evidencë të një analize për realizimin ose jo të objektivave të caktuar.

Sa i takon shembujve të tjerë të vlerësimit të brendshëm, nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit rezulton se në vitin 2017 Departamenti i Drejtësisë ka depozituar në Rektorat raportin vjetor për vitin akademik 2016-2017 (*shih evidencën nr. 34*). Ky raport më së shumti përmban një paraqitje të përgjithshme të profilit të departamentit të drejtësisë dhe programit master shkencor me profil “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare” (objektivat, vizioni, rezultatet e pritshme në fund të ciklit të studimeve) si dhe të aktiviteteve kërkimore apo didaktike përgjatë këtij viti akademik. Gjithashtu ai përmban të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve në këtë program. Në analizën SWOT, raporti evidenton dhe pesë pika të dobëta ose fusha ku mund të ketë vend për përmirësim, më konkretisht mosha e re e institucionit, njohja e gjuhës angleze nga studentët, “klonimi” (term i përdorur nga institucioni) i kurrikulës nga Universiteti i Tiranës; mungesa e ambienteve të gjelbërta dhe mungesa e përfshirjes së institucionit në nisma dhe projekte të BE. Nuk ka evidencë të raporteve të tilla për vitet e tjera akademike, si dhe të masave/hapave të ndërmarrë nga Rektorati/Senati/Departamenti për adresimin e pikave të dobëta.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se më 11 nëntor 2016 me urdhër të Rektorit është ngritur një grup i auditimit të brendshëm për kontrollin e dokumentacionit të çdo njësie



administrative dhe akademike (shih "Praktikë e auditimit të brendshëm" evidenca nr. 36) Periudha e auditimit është 2014-2016. Grupi i auditimit ka lënë dhe disa detyra për Departamentin e Drejtësisë të cilat sipas shkresës së datës 15 dhjetor 2016 të Rektoratit duhet të plotësohen deri në datën 15 Janar 2017. Grupi i auditimit të brendshëm në relacionin e datës 13 Shkurt 2017 ka bërë konstatimet përkatëse lidhur me përmbushjen e detyrave. Këto gjetje ia vënë në dijeni Rektorit. Nuk ka informacion lidhur me masat e ndërmarra nga Rekorati në drejtim të Departamentit lidhur me detyrat e papërmbushura.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Përveç masave të përmenduara më lart, institucioni në dhjetor 2014 ka kërkuar dhe hartimin e një raporti të vlerësimi të jashtëm nga ekspertja Dh.Sh (shih "Raporti i vlerësimit të jashtëm i kërkuar nga IAL", evidenca nr. 37). Inspektimi nisi në datë 31 tetor 2014 dhe përfundoi në datën 3 dhjetor 2014; Departamenti i Drejtësisë ishte pjesë e kontrollit në dt. 15 nëntor. Ekspertja ka dalë dhe me sugjerime konkrete në raport të cilat mund t'i shërbenin programit të studimit, megjithatë nuk ka evidencë të masave të mëtejshme për zbatimin e tyre.

Në përgjigje të GVJ për evidencë lidhur propozimet nga Komisioni apo Njësia lidhur me sigurimin e cilësisë dhe masat përkatëse të marra nga autoritetet drejtuese të institucionit, ky i fundit ka depozituar propozimin e Njësies drejtuar Senatit Akademik lidhur me miratimin e Rregullores së Komisionit dhe Njësies. Senati akademik me vendimin nr. 8 dhe 9 të datës 29 mars 2017 vendosi miratimin e rregullores për funksionimin e Njësise dhe Komisionit. Më tej, rezulton se në dt. 30 janar 2017, kryetari i Njësies i ka rekomandaur Dekanatit të Studentëve të organizojnë një takim informues me studentët e nivelit bachelor dhe master me qëllim nxitjen e plotësimit të anketave të vlerësimit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Plan veprimi për objektivat e kërkimit shkencor integrimin e studentëve dhe stafit të huaj hartuar nga KP
 - Propozimet e NJSBC-së dhe miratimi i propozimeve përkatëse nga Senati Akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit,</p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit në fjalë. Këtu mund të përmendim metoda të tërthorta si anketën vetëvlerësuese të stafit akademik; anketën e vlerësimit të stafit akademik ndaj institucionit; anketën e vlerësimit të stafit administrativ ndaj institucionit; anketën e vlerësimit të studentit ndaj institucionit. Në</p>


<p>përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. 	<p>fund të çdo semestri akademik studentët vlerësojnë pedagogun dhe lëndën.</p> <p>Sipas RVB (fq. 59), që nga akreditimi i mëparshëm, janë zhvilluar 12 anketime të tilla me studentë. Megjithatë nuk ka të dhëna specifike të paraqitura lidhur me numrin e përgjithshëm të studentëve të anketuar, përpunimin e të dhënave të dala nga këto anketime si dhe hapat e mëtejshëm të ndërmarrë nga njësitë përkatëse.</p>
<p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Institucioni ka depozituar si evidencë të kontrolleve të brendshme raportin vjetor të departamentit të drejtësisë për vitin 2016-2017, raportin e vlerësimit të jashtëm për vitin 2017, raportin e auditimit të brendshëm lidhur me kontrollin e dokumentacionit të çdo njësie administrative dhe akademike për vitet 2014-2016.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Institucioni synon të sigurojë cilësinë e programit të studimit nëpërmjet strukturave të qëndrueshme si Komisioni dhe Njësia. Funksionimi i këtyre dy organeve bazohet në rregulloret përkatëse.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi evidencë të një plani veprimi ndër vite lidhur me aktivitetin e Komisionit dhe Njesisë. Institucioni depozitoi dokumentin shtesë "Plan veprimi për objektivat e kërkimit shkencor integrimin e studentëve dhe stafit të</p>

Janina Riza

[Signature]

	<p>huaj hartuar nga KP” i cili përcakton hapat konkrete për t’u ndjekur nga Komisioni dhe Njësia lidhur me monitorimin e aktivitetit dhe rezultateve të kërkimit shkencor. Departamenti i Drejtësisë ka hartuar një raport vlerësimi për vitin 2016-2017.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se në vitin 2017 Departamenti i Drejtësisë ka depozituar në Rektorat raportin vjetor për vitin akademik 2016-2017. Ky raport më së shumti përmban një paraqitje të përgjithshme të profilit të departamentit të drejtësisë dhe programit master shkencor me profile e drejtë penale dhe ndërkombëtare si dhe të aktiviteteve kërkimore apo didaktike përgjatë këtij viti akademik. Gjithashtu ai përmban të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve në këtë program. Ky raport nuk përmban një përpunim të të dhënave të anketave/vlerësimeve të stafit akademik nga ana e studentëve. Nuk ka evidencë të raporteve të tilla për vitet e tjera akademike.</p> <p>Gjithashtu, institucioni në dhjetor 2014 ka kërkuar dhe hartimin e një raporti të vlerësimi të jashtëm. Inspektimi ka nisur në datë 31 tetor 2014 dhe përfundoi në datën 3 dhjetor 2014; departamenti i drejtësisë ishte pjesë e kontrollit në dt. 15 nëntor. Ekspertja ka dalë dhe me sugjerime konkrete në raport të cilat mund t’i shërbenin programit të studimit, megjithatë nuk ka evidencë të masave të mëtejshme për zbatimin e tyre.</p> <p>Së fundi, në vitin 2016 institucioni ka ngritur një grup të auditimit të brendshëm i ngarkuar me kontrollin e dokumentacionit të çdo njësie administrative dhe akademike për periudhën 2014-2016. Grupi i auditimit ka lënë dhe disa detyra për Departamentin e Drejtësisë të cilat sipas shkresës së datës 15 dhjetor 2016 të Rektoratit duhet të plotësoheshin deri në</p>

	<p>datën 15 Janar 2017. Pas këtij momenti, nuk ka evidencë për masa të ndërmarra për përmbylljen e këtij cikli monitorimi.</p> <p>Si konkluzion, institucioni ka marrë masa të shpërndara lidhur me sigurimin e sigurisë të cilat duhen përshëndetur. Megjithatë, nuk ka gjurmë të analizave vjetore nga Komisioni apo Njësia për të gjitha vitet akademike nga viti 2013.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit në fjalë. Institucioni ka krijuar Komisionin dhe Njësinë për sigurimin e cilësisë. Këto organe veprojnë mbi bazën e rregulloreve përkatëse, por një plan veprimi i detajuar mungon. Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion dëshmon për ekzistencën e <i>mekanizmave të shpërndarë</i> për kontrollin e sigurisë si vlerësimet e studentëve – por që mbeten të paflektuara në një raport vjetor të Komisionit/Njësisë apo Departamentit përkatës, auditimi i brendshëm lidhur me dokumentacionin, auditimi i jashtëm. Nuk ka evidencë të raporteve vjetore të Komisionit apo Njësisë për të gjithë periudhën 2013-2019. Gjatë vizitës në institucion u konfirmua se institucioni merr masa për ndërgjegjësimin e stafit lidhur me sigurimin e cilësisë dhe organizon trajnime lidhur me këtë çështje siç rezultojnë dhe nga evidenca nr. 32 mbi listën e trajnimeve të stafit akademik dhe administrativ ku janë përfshirë dhe trajnime mbi sigurimin e cilësisë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni përdor metodologji të tërthorta për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit në fjalë. 2. Komisioni dhe Njësia e sigurimit të cilësisë janë krijuar si njësi të përhershme të ngarkuara me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Pra, institucionalizimi i sigurimit të cilësisë nëpërmjet Komisionit dhe Njësisë dhe rregullimi i detajuar i funksioneve të tyre 	



përbën një zhvillim pozitiv.

3. Këto njësi veprojnë mbi bazën e rregulloreve përkatëse por një plan veprimi i detajuar - me përjashtim të monitorimit të kërkimit shkencor - mungon. Gjithashtu ka "gjurmë" të disa aktiviteteve monitoruese por që gjithsesi mbeten të shpërndara si psh. auditimi i brendshëm i vitit 2016 për dokumentacionin në njësitë administrative dhe akademike, raporti vjetor i departamentit për 2016-2017 apo raporti i vlerësimit të jashtëm i vitit 2014. Megjithatë, funksionimi i Komisionit dhe Njesisë nuk mbulon plotësisht fushat e veprimit të përcaktuara në rregulloret përkatëse: nuk ka evidencë për vlerësimin në mënyrë periodike të përvitshme të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore apo të reflektimit mbi anketat e studentëve ndaj stafit akademik. Gjithashtu nuk ka evidencë të paraqitur për vlerësimin e ecurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit, për ndjekjen e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Raportimet dhe propozimet drejtuar Senatit Akademik lidhen me propozime specifike si psh miratimi i rregulloreve të Komisionit dhe Njesisë apo miratimin e udhëzimit mbi procesin e zhvillimit të kurrikulave.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE


7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi master në drejtësi ka si objektiva përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t'i shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në një përmbledhje të arritjeve që synon programi master në të dy profilet, mund të thuhet se programet e profileve synojnë përvetësimin e koncepteve bazë juridike në fushën e të drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare, aftësimin praktik të studentëve dhe përcjelljen e zhvillimeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare dhe përgatitjen e specialistëve në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë. Numri minimal i studentëve në programin "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare* është gjashtë dhe ai maksimal është pesëdhjetë. Sipas nenit 5 të rregullores së programi gjuha e studimeve në programin "Master i Shkencave" në Drejtësi është si më poshtë:

1. Profili "E drejtë penale", gjuha e programit të studimit është gjuha shqipe dhe disa lëndë ofrohen në gjuhën angleze.



2. Profili “E drejtë ndërkombëtare”, gjuha e programit të studimit është gjuha angleze dhe disa lëndë ofrohen në gjuhën shqipe.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Master i Shkencave në “Drejtësi” me profile: “E drejtë penale”; “ E drejtë ndërkombëtare”, organizohen sipas sistemit me kohë të plotë sipas Urdhërit Nr. 10, datë 16.01.2012 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë që përfundojnë me “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”. Programi ka për qëllim arsimimin akademik dhe përgatitjen e studentëve me një bagazh të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive. Programi realizohet me 120 ECTS. Sipas rregullores së programit, Programi i studimit përbëhet nga 15 lëndë si dhe teza e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Një vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. Programi organizohet në dy vite akademike, i ndarë në katër semestra. Një vit akademik ka 60 ECTS. Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit 1 orë mësimore = 50 minuta (sipas rregullores së institucionit 60 min). Viti akademik ka 32 javë mësimore. Sipas nenit 78 të rregullores së institucionit viti akademik përbëhet nga semestri i vjeshtës dhe i pranverës. Sezone të veçanta mund të zhvillohen me miratim të Senatit Akademik. Kohëzgjatja normale e secilit semestër është 16 javë. Në raste të nevojshme, kohëzgjatja e tyre mund të shtyhet nga Senati Akademik. Viti akademik organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratore në javë. Një semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabelat 13, 15, 16 dhe 18 të Anekseve)

Në planin mësimor ngarkesa e lëndëve është e përcaktuar në bazë të numrit të krediteve sipas sistemit ECTS/ orë mësimore në auditor. Organizimi i krediteve është 6 kredite të gjitha lëndët të detyrueshme e me zgjedhje, pa dallim në ngarkesë midis tyre. “Metodat e kërkimit”, lëndë e posaçme dhe “E drejta ndërkombëtare penale” 64 orë në auditor, me 66 orë punë e pavarur, 20 orë provime, për një total 150 orë. Kurse lëndët e tjera kanë 6 kredite, 4 kredite janë 48 orë leksione dhe 52 orë punë e pavarur, 2 kredite janë seminare me 16 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur për një total prej 64 orësh mësimore dhe 66 orë punë e pavarur. Në total nga zberthimi i krediteve rezulton se 1 kredit përfshin 10.5 orë në auditor, pjesa tjetër orë studimi punë e pavarur dhe orë provimesh. Sipas akteve nënligjore, krediti është i përbërë nga orë në auditor, orë praktike, laboratorike dhe punë e pavarur studimi.

Sipas nenit 9 rregullores së programit, Komiteti Shkencor mund të njohë si kredite të formimeve universitare në Programin e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili “E drejtë penale” dhe profili “E drejtë ndërkombëtare” deri në 40 ECTS të njohurive të veprimtarive formuese të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit. Syllabuset përgjithësisht kanë të përbashkët elementët e emërimit të lëndës, viti e semestri i realizimit, emri i pedagogut/grupin e pedagogëve, njohuritë që i jep studentit, temat e programit, si edhe numrin e ECTS të lëndës. Në organizimin e *Veprimtarive Formuese (A-E) në të dy profilet*, veprimtaritë janë të organizura sipas kategorive A-F. Me hyrjen në fuqi të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 veprimtaritë për vitin akademik 2018-2019 duhen organizuar A-E. (*Shih Tabelat 15-18*).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (*Tabelat 14 dhe 17 të Aneksëve*):

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për profilin “E drejtë penale”:


○ Leksionet	928 orë në auditor dhe 934 orë punë e pavarur e studentit
○ Seminaret	32 orë në auditor dhe 56 orë punë e pavarur e studentit
○ Labororet	0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
○ Praktikat lëndore	0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
○ Praktikën Profesionale	0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
○ Provimi përfundimtar	32 orë në auditor dhe 288 orë punë e pavarur e studentit
○ Teza	32 orë në auditor dhe 698 orë punë e pavarur e studentit

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për profilin “E drejtë ndërkombëtare”:

○ Leksionet	768 orë në auditor dhe 822 orë punë e pavarur e studentit
○ Seminaret	192 orë në auditor dhe 168 orë punë e pavarur e studentit
○ Labororet	0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
○ Praktikat lëndore	0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
○ Praktikën Profesionale	0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
○ Provimi përfundimtar	32 orë në auditor dhe 288 orë punë e pavarur e studentit
○ Teza	32 orë në auditor dhe 698 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Programi në vite në të dy profilet ka pasur ndryshime të vogla në 1-2 lëndë përgjatë viteve akademike, të cilat nuk prekin profilin dhe organizimin e programit. Kështu në profilin “E drejtë penale” programi formal i paraqitur ka 15 lëndë 1 tezë; ndërkohë në vitin 2014-2015 programi përmban 16 lëndë dhe 1 tezë si dhe rezultojnë të zgjedhura 2 lëndë respektivisht të semestrit I dhe semestrit të II të vitit të parë, në raport me 1 lëndë të parashikuar respektivisht për semestër sipas planprogramit. Në vitin 2015-2016 nuk rezultojnë 1 lëndë e zgjedhur nga grupi i lëndëve me zgjedhje në lëndët të semestrit të dytë duke zbritur në 15 lëndë. Në vitin 2016-2017 është shtuar





numri i tezës në 2 komponentë në program dhe është përfshirë lënda “E Drejtë e Bashkimit Evropian”. (Tabela 19 e Anekseve).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë dhe cilësia e syllabuseve.


Nga rishikimi me kujdes i syllabus-eve të lëndëve, përgjithësisht gjenden elementë uniform si: Emërtimi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri/at i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, objektivat që synohen të përmbushen, njohuritë që përfitohen, temat që trajton lënda, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS, format e mësimdhënies, mënyra e vlerësimit të studentëve, literatura e lëndës. Ka lëndë, programet e të cilave, kanë nevojë të adresojnë objektivat e lëndës në mënyrë ezauruese. Kështu syllabusi i lëndës “Organizata dhe institucione ndërkombëtare” rezulton me tema jo eazuruese, syllabusi nuk përmban asnjë temë mbi organizatën e Këshillit të Evropës, Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë, etj.

Po kështu, në lëndën “History and Theory of International law”, sipas përshkrimit në objektivat e lëndës: *Attention will be paid both to classical analyses of the nature of international law (positivism and its alternatives) and to some of the recent critiques of international law from perspectives such as critical legal studies, feminist legal theory, international relations theory, etc. Particular topics to be examined will be chosen having regard to the interests of students taking the course.*

Kjo qasje tejet e avancuar e programit të lëndës, e krahasueshme me studime në fushën e shkencave politike nuk duket të përmbushet në tematikën e programit që në drejtim të rrymave filozofike të mendimit në syllabus nuk përfshin tema mbi *feminist legal theory, international relations*. Në përgjithësi, lënda duhet të synojë edhe aftësimin praktik të studentëve në përmbushje edhe të objektivave të programit si:

Examine the function and purpose of international law, in particular the concept of State sovereignty; Provide you with a solid conceptual understanding of international law Help you to appreciate the dynamic and evolving nature of international law.

Lënda “Tema Specifike në Drejtësi” nuk ka një drejtim midis temave të trajtuara të cilat variojnë nga e drejta e BE-së tek mjedisi, konkurrenca, mbrojtja e konsumatorit, market tregtare, tregtia elektronike, ligji i teknologjisë elektronike, pronësia intelektuale, etj. Ndonëse qëllimi i lëndës është t’u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në tema specifike, formati aktual është i shpërndarë dhe rrezikon të mos ofrojë thellësinë e nevojshme në secilën nga temat dhe koherencën e përgjithshme të lëndës. Sugjerohet të përzgjidhet një drejtim i së drejtës (psh. sfidat globale dhe e drejta ndërkombëtare ose integrimi ekonomik në BE dhe me vendet e treta) i cili të zbërthehet nëpërmjet temave specifike dhe aktuale. Lënda “European Union Law” ofron një strukturë jo të zakonshme e të përshtatshme për këtë lëndë që potencialisht vështirëson arritjen e objektivave të lëndës: ajo fillon me një analizë të së drejtës substanciale të BE-së (tregu i përbashkët) dhe më pas vazhdon me të drejtën institucionale të BE-së përfshirë dhe zhvillimin historik dhe mënyrën e zbatimit të së drejtës europiane.



Në programin e profilit “E drejtë ndërkombëtare”, lëndët *The Law of Treaties, The Law of Diplomatic and Consular Relations, International Criminal Law, Legal Regulation of International Security, The Law of Armed Conflicts* janë parashikuar si lëndë me zgjedhje ndërkohë që janë lëndë themelore të studimit të së drejtës ndërkombëtare; lëndë të tjera si *International Investment Law, International Intellectual Property law* janë përfshirë si lëndë të detyrueshme. Për të adresuar qasjen më të drejtë në lidhje me lëndët themelore dhe ato me zgjedhje për sa më sipër, mund të jetë e nevojshme të përcaktohet një drejtim qëndror i studimit të së drejtës ndërkombëtare. Në një reflektim të përgjithshëm, megjithë diversitetin e kurrikulave të programeve Master në të Drejtë Ndërkombëtare, përgjithësisht prevalon qasja e fokusimit të programit në një drejtim të posaçëm në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Pra, në studimin e të drejtës ndërkombëtare mund të zgjidhet një drejtim themelor i fushës së studimit në fushën publike ose private i cili të karakterizojë programin duke mundësuar njëkohësisht edhe informacion në drejtimin tjetër të studimit privat ose publik. Ka gjithashtu një paqëndrueshmëri në drejtim të komponentit Tezë që shfaqet me ngarkesë orësh disa herë në program dhe ndarë midis lektorëve të ndryshëm. Në tërësi planprogramet duhet të ruajnë një qëndrueshmëri e qartësi në komponentët që janë pjesë e programit të miratuar. Po kështu, në programet e të dy profileve mungojnë orët e praktikës; sidoqoftë në program ka lëndë të tilla si “Tema Specifike në Drejtësi” dhe “Tema Specifike në Drejtësi dhe Siguri”, kjo e fundit në vitin 2017-2018 e ofruar 2 herë si lëndë. Këto lëndë në thelb janë lëndë me orientim praktik të natyrës së klinikës së ligjit; pra përcaktimi i tyre si lëndë duhet rishikuar dhe duhen zhvilluar në kuadër të orëve praktike etj.

Në lidhje me literaturën, ka lëndë burimet e të cilave janë të pamjaftueshme në syllabusin e lëndës duke u kufizuar në vetëm pak burime të cilat në disa raste përmbajnë më së shumti legjislacion kombëtar apo traktate/konventa si material të detyrueshëm. Gjithashtu do të ishte e përshtatshme që lëndët që ofrohen në gjuhën angleze të përcaktohen qartë në rregulloren e programit dhe në planprogram në mënyrë që të dallohet shtrirja e këtij tipari që është pozitiv e i vlerësueshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Drejtësi”, me profile: “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare” është hapur me Urdhërin Nr. 10, Datë 16.01.2012 “Për Hapjen e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë që Përfundojnë me “Master Profesional” “Master i Shkencave”. Programi organizohet sipas sistemit me kohë të plotë me 120 ECTS. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Studentët që përfundojnë me sukses programin Master i Shkencave në “Drejtësi”, profili “E drejtë penale”</p>

	<p>pajisen me diplomë “Master i Shkencave në “Drejtësi”, profili “E drejtë penale””. Studentët që përfundojnë me sukses programin Master i Shkencave në “Drejtësi”, profili “E drejtë ndërkombëtare” pajisen me diplomë “Master i Shkencave në “Drejtësi”, profili “E drejtë ndërkombëtare””.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi Master Shkencor në Drejtësi në profilin e Drejte Penale dhe e Drejtë Ndërkombëtare ka si objektiva përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në një përmbledhje të arritjeve që synon programi master në të dy profilet, mund të thuhet se programet e profileve synojnë përvetësimin e koncepteve bazë juridike në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare, aftësimi praktik i studentëve dhe përcjellja e zhvillimeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare dhe përgatitja e specialistëve në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.</p> <p>Duke marrë në konsideratë disa nga problematikat e shprehur më lart mbi përmbajtjen e programit dhe pranimet nga fusha jo të afërta me drejtësinë, mund të thuhet gjithsesi me kurrikulën e programit përgjithësisht se mund të arrihet një bazë e vlefshme edukimi për të diplomuarit në fushën e drejtësisë për të vijuar thellimin e studimit në programet të ciklit të tretë në fusha të lidhura me të drejtën ndërkombëtare dhe atë penale.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të</p>	<p>Në vlerësim të parashikimeve të Rregullores së</p>

programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Programit Master Shkencor mund të thuhet se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e qëllimeve në mënyrë të përshtatshme me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; sidoqoftë ka nevojë për përmirësim të kurrikulës në disa drejtime si më poshtë.

Ka lëndë, programet e të cilave, kanë nevojë të adresojnë objektivat e lëndës në mënyrë ezauruese. P.sh siç është evidentuar dhe më sipër, lënda: “*Organizata ndërkombëtare*” në profilin “E drejtë ndërkombëtare”, nuk ezauron në program tematikën e plotë që duhet të ketë lënda; kështu nuk përmban asnjë temë mbi organizatën e Këshillit të Evropës, Organizatën për Siguri e Bashkëpunim në Evropë, etj. Po kështu, në lëndën *History and Theory of International law*, sipas përshkrimit në objektivat e lëndës, të krahasueshme me objektiva studimesh në disiplina të shkencave politike, tematika e programit nuk duket të përmbushet në drejtim të rrymave filozofike të mendimit që përmenden në përmbledhjen e objektivave të lëndës duke u përqëndruar në tema të tjera si “*The Move to Abstraction: Kelsen's Pure Theory of Law, Rule of Law and the Rule of Lawyers: Lauterpacht's and the Victorian Tradition, An Alternative Meaning of Liberalism: Carl Schmitt, Hans Morgenthau and the Critique of Universal Moralism*, etj. Në përgjithësi, lënda duhet të synojë aftësimin praktik duke vlerësuar dhe objektivat e lëndës sipas përshkrimit të saj. Lënda *Tema Specifike në Drejtësi* nuk ka një drejtim të qartë në temat e trajtuara të cilat variojnë nga e drejta e BE-së tek mjedisi, konkurenca, mbrojtja e konsumatorit, markat tregtare, tregtia elektronike, ligji i teknologjisë elektronike, pronësia intelektuale etj. Duke qenë se qëllimi i lëndës është t’u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në tema specifike, formati aktual është i shpërndarë dhe rrezikon të mos ofrojë thellësinë e nevojshme në secilën nga temat dhe koherencën e përgjithshme të lëndës. Sugjerohet të përzgjidhet një drejtim i së drejtës (psh. sfidat globale dhe e drejta ndërkombëtare ose integrimi ekonomik në BE dhe me vendet e treta) i cili të zërthehet nëpërmjet temave specifike dhe aktuale. Lënda *European Union*

	<p><i>Law</i> ofron një strukturë jo të zakonshme e të përshtatshme për këtë lëndë e cila vështirëson arritjen e objektivave të lëndës: ajo fillon me një analizë të së drejtës substanciale të BE-së (tregu i përbashkët) dhe më pas vazhdon me të drejtën institucionale të BE-së përfshirë dhe zhvillimin historik dhe mënyrën e zbatimit të së drejtës europiane.</p> <p>Në programin e profilit “E drejtë ndërkombëtare”, lëndët <i>The Law of Treaties, The Law of Diplomatic and Consular Relations, International Criminal Law, Legal Regulation of International Security, The Law of Armed Conflict</i>, janë paarshikaur si lëndë me zgjedhje ndërkohë që janë lëndë themelore të studimit të së drejtës ndërkombëtare; lëndë të tjera si <i>International Investment Law, International Intellectual Property Law</i> janë përfshirë si lëndë të detyrueshme. Për të adresuar qasjen më të drejtë në lidhje me lëndët themelore dhe ato me zgjedhje për sa më sipër, mund të jetë e nevojshme të përcaktohet një drejtim qëndror i studimit të së drejtës ndërkombëtare. Në një reflektim të përgjithshëm megjithë diversitetin e kurrikulave të programeve Master në të Drejtë Ndërkombëtare në programe të ciklit të dytë përgjithësisht prevalon qasja e fokusimit të programit në një drejtim të posaçëm në fushën e të drejtës ndërkombëtare. Pra në studimin e të drejtës ndërkombëtare mund të zgjidhet një drejtim themelor i fushës së studimit në fushën publike ose private i cili të karakterizojë programin duke mundësuar njëkohësisht edhe informacion në drejtimin tjetër të studimit privat ose publik. Në drejtim të personelit akademik të angazhuar mund të vlerësohet më mirë lidhja e profilit të lektorit me fushën e lëndës së angazhuar.</p> <p>Në lidhje me vlerësimin, rregullorja e ciklit të dytë, neni 35-37 parashikon rregullat për vlerësimin e studentëve. Sipas nenit 35 niveli i përparimit të studentëve matet me anë të provimeve gjysmëpërfundimtare, provimeve përfundimtare, detyrave të kursit, projekteve e prezantimeve, të cilat zhvillohen brenda semestrit të caktuar. Provimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda</p>
--	--

Daniela Pajari

	<p>afatit të përcaktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e tyre shpallen, të paktën dy javë përpara sezonit të provimeve. Lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij. Kur lëndën e zhvillojnë disa pedagogë, të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit.</p> <p>Provimet përgatiten dhe drejtohen nga pedagogët që japin lëndën përkatëse. Në rast se pedagogu i lëndës nuk ndodhet në Kolegjin Universitar “Bedër” ditën e provimit, atëherë bashkërenduesi i programit përcakton se kush do të organizojë provimin.</p>
--	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara

Në një përmbledhje të arritjeve që synon programi master në të dy profilet, mund të thuhet se nga programet e profileve synohet përvetësimi i koncepteve bazë juridike në fushën e të drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare, aftësimi praktik i studentëve dhe përcjellja e zhvillimeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare dhe përgatitja e specialistëve në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë. Sipas nenit 5 të rregullores së programi gjuha e studimeve në profilin “E drejtë penale” është gjuha shqipe dhe disa lëndë ofrohen në gjuhën angleze. Në profilin “E drejtë ndërkombëtare”, gjuha e programit të studimit është gjuha angleze dhe disa lëndë ofrohen në gjuhën shqipe. Mund të thuhet se gjuha anglisht në disa pjesë të programit është element që mundëson konkurrueshmërinë dhe përjasjen e programeve me zhvillimet në fushën e drejtësisë dhe legjislacionin e huaj; do ishte e përshtatshme që përcaktimi i lëndëve në gjuhë të huaj të bëhej në rregullore e planprogram për të evidentuar shtrirjen e këtij tipari.


Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën

Programi master në drejtësi ka si objektiva përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Programi i studimit është i lidhur me profilin e Institucionit si Kolegj Universitar në fushën e arsimit të lartë dhe objektivat në fushën e edukimit ligjor. Mund të thuhet se përgjithësisht




<p>kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>personeli akademik angazhohet dhe mbështetet nga ana e institucionit për punë kërkimore shkencore për realizimin e programit të studimit, për të ofruar nivelin më cilësor e të fundit në fushën përkatëse.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” është të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, për të ndërmarrë kërkime shkencore të vlefshme për specifikën shqiptare e atë ndërkombëtare. Në përmbushje të këtyre objektivave, referuar parashikimeve në Rregulloren e programit Master Shkencor në Drejtësi, respektivisht në profilin e drejtë ndërkombëtare dhe e drejtë penale, programet kanë për qëllim arsimimin akademik dhe përgatitjen e juristëve me një bagazh të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive.</p> <p>Institucioni ka një studim formal mbi tregun e punës në lidhje me përthithjen e studentëve që përfundojnë programet e ciklit të dytë të studimeve dhe përshtatshmërinë e programeve të ofruara në drejtim të nevojave të tregut. Sipas informacionit të ofruar në Institucion, për përmirësimin e programit Master, Institucioni organizon edhe aktivitete praktike të ndryshme për të vlerësuar kërkesat e pritshmëritë e tregut si dhe mban kontakte me alumni të programeve të tij nëpërmjet klubeve e organizimeve të tyre. Nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të ndryshme dhe komunikimeve të drejtpërsëdrejta me përfaqësues të institucioneve vlerësohet dhe shpërndahet informacion mbi programin duke nxitur ndjekjes së tij nga personeli i tyre.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave</p>	

kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe mund të thuhet se në një përmirësim të standardeve sipas observimeve programi i studimit do të ndihmojë më shumë në zhvillimin e vlerave kulturore kombëtare të cilat përfshijnë edhe vlerësimin e njohjen e rregullimeve në fusha të reja të zhvillimit të së drejtës.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi realizohet me 120 kredite europiane ECTS; 30 kredite janë përcaktuar për objektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja e tyre është 2 vite akademike.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	N/A
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	N/A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe konsultimit me informacionin që disponohet në Institucion rezulton se studentëve u ofrohet informacion i qartë dhe i konsultueshëm në lidhje me mënyrën e organizimit të institucionit, programet që ofrohen, modulet dhe syllabuset, etj.</p>
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Rregullorat e programit Master shpjegojnë mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve, detyrime në lidhje me afatet, pasojat etj; 30 kredite janë përcaktuar për objektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të</p>

Konkluzionet e vlerësimit:


1. Programi realizohet me 120 kredite europiane sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); 30 kredite janë përcaktuar për objektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja e tyre është 2 vite akademike, ndarja e krediteve në 2 vite rezulton 60 me 60.
2. Sipas nenit 5 të rregullores së programit gjuha e studimeve në profilin “E drejtë penale” është gjuha shqipe dhe disa lëndë ofrohen në gjuhën angleze. Në profilin “E drejtë ndërkombëtare” gjuha e programit të studimit është gjuha angleze dhe disa lëndë ofrohen në gjuhën shqipe. Gjuha anglisht në disa pjesë të programit është element pozitiv që mundëson konkurrueshmërinë dhe përfaqshen e programeve me zhvillimet në fushën e drejtësisë dhe legjislacionin e huaj.
3. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e qëllimeve në mënyrë të përshtatshme me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; sidoqoftë ka nevojë për përmirësim të kurrikulës në disa drejtime në mënyrë që të sigurohet koherenca e tyre e brendshme si dhe koherenca me programin e studimit në fjalë. Në studimin e së drejtës ndërkombëtare mund të zgjidhet një drejtim themelor i fushës së studimit në fushën publike ose private i cili të karakterizojë programin duke mundësuar njëkohësisht edhe informacion në drejtimin tjetër të studimit privat ose publik.
4. Për vitin akademik 2018-2019 duhej bërë organizimi i kategorive A-F, sikurse kërkohet nga VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.

8. Mësimdhënia**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Programi i studimit Msc. Drejtësi, me profile në të drejtë penale dhe ndërkombëtare bazohet në lëndë që u japin studentëve instrumentat e kërkimit shkenocor (si psh *Metoda Kërkimore*), lëndë të detyrueshme që përbëjnë thelbin e profileve përkatëse si dhe lëndë me zgjedhje. Gjithashtu në përfundim të programit studentët përgatisin dhe tezën e diplomës.

Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë përmban “rregullat e funksionimit të këtyre programeve dhe të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në veprimtaritë e tyre. Ajo përcakton strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të programeve të studimit të ciklit të dytë, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, raportet ndërmjet tyre, si dhe harton rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, kërkimin, praktikën, vlerësimin, diplomimin dhe sanksionet në rast shkeljeje të rregullores.” (*neni 1 i Rregullores, shih evidenca nr. 6*). Në bazë të nenit 4 të Rregullores së programit të studimit në fjalë (*evidenca nr. 29*), plani




mësimor propozohet nga Departamenti i Drejtësisë me vendim të Dekanatit të Fakultetit dhe miratuar nga Senati akademik. Sipas RVB (fq. 91) në çdo fillim semestri “miratohen ngarkesat mësimore, shpërndarja e lëndëve, mbledhja e dokumentacionit përkatës për çdo lëndë, plotësimi i programeve mësimore”.

Sa i takon formave të mësimdhënies, programi ofron një kombinim midis leksioneve dhe seminareve (*Tabela 21 e Aneksëve*). Siç dhe u konfirmua gjatë vizitës në institucion, stafi akademik synon vendosjen e metodës sokratike si standardi bazë metodologjik në mësimdhënie. Kjo bën që si seminarët por dhe leksionet të jenë interaktive. Ky fakt u konfirmua dhe në takimet me studentët. Pedagogët kanë liri akademike në përcaktimin e përmbajtjes së syllabus-ëve në përputhje me objektivat e programit të studimit; gjithashtu ata janë përgjegjës për përditësimin e tyre. Siç është përmendur dhe më lart, një nga format e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies është përmes anketave/vlerësimeve të studentëve për pedagogët të cilat zhvillohen në përfundim të lëndës. Ky fakt u konfirmua dhe nga biseda me studentët. Sa i takon mënyrave të kontrollit të njohurive të studentëve, nga një rishikim i hollësishëm i syllabus-ëve rezultoi se ky kontroll përgjithësisht bazohet në pjesëmarrje të studentit, provim i pjesshëm si dhe provimi përfundimtar. Gjithashtu vihet re se mësimdhënia në disa lëndë është në gjuhën shqipe, ndërsa për të tjera në gjuhën angleze pavarësisht se gjuha e programit është shqipja. Kjo praktikë mbështetet dhe në nenin 13 të rregullores së studimeve dhe programeve të ciklit të dytë sipas të cilit “programet e studimit të ciklit të dytë zhvillohen në gjuhën shqipe dhe/ose angleze”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (*Tabela 21 e Aneksëve*)


Sic shihet në *Tabelën 21* format kryesore të mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet dhe seminarët. Siç u konfirmua dhe nga takimi me stafin dhe studentët mësimdhënia është interaktive. Programi nuk parashikon praktikën profesionale si pjesë e detyrueshme e programit. Megjithatë rezultoi se në periudhën 2013-2018, 5 studentë të programit master shkencor me profil të drejtë penale ose ndërkombëtare kanë kryer praktikën profesionale pranë shërbimit të provës, gjykatës së shkallës së parë Tiranë apo Komisionit Parlamentar të Edukimit dhe Medias (*shih Listë e praktikave profesionale, evidenca nr. 31*).

- Format e kontrollit të njohurive (*Tabela 22 e Aneksëve*)

Format e kontrollit të njohurive parashikohen në syllabus-in e lëndës dhe mund të variojnë për secilën lëndë; megjithatë parimi kryesor është ai i disa komponentëve në vlerësim të cilët janë: ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrave të kursit, provimi i pjesshëm si dhe provimi përfundimtar.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (*Tabela 23 e Aneksëve*)

Sipas dokumentacionit të depozituar nga institucioni, 40 studentë janë përfshirë në punime shkencore individuale të pedagogëve; 70 në projekte shkencore në rang departamenti; 40 në projekte shkencore në rang Fakulteti dhe 35 studentë në projekte në bashkëpunim me të tjerë.



GVJ nuk disponon të dhëna konkrete të këtyre përfshirjeve, por ky fakt u konfirmua nga biseda me stafin akademik të cilët përmendën si shembull aplikime nga ana e studentëve për vende të lira si asistentë kërkimor. Gjatë periudhës 3-4 mujore si asistentë kërkimor, këta studentë inkurajohen të fokusohen më tepër në kërkim në krahasim me studentët e tjerë të programit. Gjithashtu studentët e këtij programi janë përfshirë në Konferencen studentore në drejtësi si dhe në konkursin ndërkombëtar të gjyqit imitues për të drejtën ndërkombëtare (Jessup) që zhvillohet në Washington D.C dhe ku marrin pjesë universitete nga e gjithë bota.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Model vlerësimi praktike studentore

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në bazë të nenit 76 të Ligjit për Arsimin e Lartë, “*pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë*”. Neni 15 i rregullores së studimeve dhe programeve të ciklit të dytë përmend si kriter bazë të pranimit në programet e ciklit të dytë të gjithë “*ata persona që zotërojnë një diplomë të nivelit të parë, të vlerësuar nga Kolegji Universitar, diplomë të nivelit të dytë, diplomë DIND, diplomë studimi të sistemit të mëparshëm, të pandarë në cikle studimi, a diplomë tjetër studimi universitar, të fituar jashtë vendit e barasvlerësuar nga MASR*.” Gjithashtu një tjetër kriter bazë pranimi është dhe njohja e “një prej pesë gjuhëve të huaja, përkatësisht: Gjuhës angleze, Gjuhës frënge, Gjuhës gjermane, Gjuhës italiane dhe Gjuhës spanjolle. Studentët që kanë fituar një diplomë të një programi studimi, kryer në një nga këto gjuhë, me anë të paraqitjes së saj, dëshmojnë për plotësimin e këtij kriteri.” Kjo rregullore përcakton si nivel minimal të njohjes së gjuhës së huaj nivelin B1. Në bazë të nenit 16 të kësaj rregulloreje pranimi i studentëve “*kryhet në bazë të vlerësimit të rezultateve të studimeve universitare dhe intervistës*.” Gjithashtu “*Përzgjedhja e aplikuesve bëhet në rend zbritës nga rezultate më të larta në ato më të ulëta. Për ata që janë me mesatare të barabarta, u jepet përparësi rezultateve të provimit të gjuhëve të huaja dhe pjesëmarrjeve në aktivitete akademike*”. Studentët, aplikimi i të cilëve për pranim është pranuar duhet të kryejnë regjistrimin pranë sekretarisë mësimore duke paraqitur, përveç dokumentave të përcaktuar në mënyrë të përvitshme në udhëzimet e nxjerra nga MASR, dhe këto dokumenta shtesë:

1. Formular i plotësuar i aplikimit;
2. Letër motivimi;

3. Fotokopje e noterizuar e diplomës së kandidatit ose e një dokumenti që vërteton diplomimin (diploma e universiteteve të huaja duhet të jetë e legalizuar me vulë Apostil);
4. Lista zyrtare e notave nga universiteti/institucioni i arsimit të lartë, ku tregohen të gjitha lëndët që studenti ka marrë, si edhe notat përkatëse;
5. Dokumenti që dëshmon njehsimin e diplomës, në rast se kandidati ka përfunduar studimet në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit;
6. Dëshmia e noterizuar e gjuhës së programit;
7. Fotokopje e letërnjoftimit (për kandidatët e huaj, fotokopja e noterizuar dhe e përkthyer në shqip e pasaportës);
8. Leja e qëndrimit e studentëve të huaj;
9. 6 fotografi me përmasa 4,5x6 cm (fotografitë duhet të jenë me veshje të përshtatshme)

Në bazë të nenit 12 të rregullores së studimeve dhe programeve të ciklit të dytë, sekretaria mësimore mban peshën kryesore në proceset regjistruese dhe mbarëvajtjen e proceseve administrative për studentin. Kështu kjo sekretari “bën regjistrimin e studentëve të rinj; pajis të gjithë studentët rishtarë me kartë studenti, plotëson kërkesat e studentëve për vërtetime të thjeshta, listë notash e dokumente të tjera; raporton në bazë të kërkesës së organeve kolegjiale në formë statistikore mbi vlerësimin e studentëve; hedh notat në regjistrin themeltar, sipas kurseve dhe lëndëve, përgatit diplomat dhe transkriptet për studentët që përfundojnë studimet; mban lidhje me Dekanatin dhe Komitetin shkencor dhe raporton të dhënat statistikore të programeve të studimit të ciklit të dytë në instancat përkatëse.” Për të gjithë studentët e pranuar në programet e studimit, institucioni ka miratuar “Guidën e Studentit” (*evidenca nr. 42*) një dokument orientues lidhur me institucionin, shërbimet e në dispozicion të studentit, zyrat përkatëse, rregullat akademike, çështje administrative dhe të lidhura me programin e studentit (si regjistrimi i lëndëve, metodat e vlerësimit, sezoni i provimeve, diplomimi, procedurat ankimore etj).

Rregullorja e organizimit administrativ (*evidenca nr. 5*) parashikon në nenin 40 funksionet e drejtorisë së marrëdhënieve me studentët. Në mënyrë të përgjithshme drejtuesi i kësaj drejtorie “është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me Kolegjin Universitar “Bedër”. Ai koordinon aktivitetet socio-kulturore të studentëve dhe kryen detyrat e tij, në bashkëpunim me organet drejtuese”. Në varësi të kësaj drejtorie janë zyrat e mëposhtme: zyra e planifikimit të karrierës; zyra e koordinimit të klubeve studentore; zyra e të diplomuarve; zyra e shërbimit psiko-social dhe shëndetësor. Kjo strukturë u konfirmua dhe gjatë vizitës në institucion, më konkretisht në takimin me përfaqësuesit e drejtorisë dhe zyrave. Zyra e planifikimit të karrierës ka për qëllim, ndër të tjera, “afrimin e institucioneve të sektorit privat ose publik me studentët aktualë ose të diplomuar, të cilët përbëjnë burime njerëzore të mirëkualifikuara” nëpërmjet organizimit të takimeve “mes studentëve universitarë dhe atyre të diplomuar dhe institucioneve të ndryshme në sektorë të ndryshëm, informimi i studentëve me profesionet përkatëse, eksperiencat e punës dhe mundësitë e karrierës, si dhe vendosjen e lidhjeve mes institucioneve që kërkojnë persona për të punësuar dhe studentëve” (*neni 41 i rregullores së organizimit administrativ*). Gjatë bisedës me përfaqësuesin e zyrës së planifikimit të karrierës GVJ u informua se kjo zyrë organizon ndër të tjera ditën e orientimit apo dhe seminare informuese si psh. seminari mbi mundësitë e studimit jashtë vendit. Konkretisht për programin e studimeve në drejtësi, institucioni ka patur të ftuar përfaqësues nga Education USA

të cilët prezantuan mundësitë e studimit në ShBA. Sa i takon lidhjes së studentëve me tregun e punës kjo zyrë i asiston studentët lidhur me praktikat profesionale. Lidhur me suksesin e kësaj zyre, përfaqësuesi informoi GVJ se të dhënat e të diplomuarve mbahen nga zyra e karrierës dhe për studentët të cilët gjejnë një punë nuk mbahen shënime pasi në gjetjen e punës mund të ndikojnë shumë faktorë.

Në bazë të dokumentacionit të marrë në institucion, rezulton se në profilin e së drejtës ndërkombëtare, për periudhën 2014-2018, janë regjistruar 28 studentë nga të cilët 12 janë diplomuar, 11 vazhdojnë studimet dhe 5 janë çregjistruar. Për profilin e së drejtës penale, për të njejtën periudhë, 70 studentë janë regjistruar, nga të cilët 27 janë diplomuar, 15 vazhdojnë studimet dhe 19 janë çregjistruar. (shih "Statistikat mbi studentët e Msc. Drejtësi", evidencë shitesë).

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Neni 15 i rregullores së studimeve dhe programeve të ciklit të dytë përmend si kritere bazë të pranimit në programet e ciklit të dytë të gjithë "ata persona që zotërojnë një diplomë të nivelit të parë, të vlerësuar nga Kolegji Universitar, diplomë të nivelit të dytë, diplomë DIND, diplomë studimi të sistemit të mëparshëm, të pandarë në cikle studimi, diplomë tjetër studimi universitar, të fituar jashtë vendit e barasvlerësuar nga MASR". Gjithashtu një tjetër kriter bazë pranimi është dhe njohja e "një prej pesë gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle." Kjo rregullore përcakton si nivel minimal të njohjes së gjuhës së huaj nivelin B1.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 24.1, 24.2, 25.1 dhe 25.2 e Aneksëve)

Bazuar në RVB si dhe sipas informacionit të depozituar nga institucioni rezultojnë këto të dhëna:

a. Programi Msc. Drejtësi / Profili "E drejtë ndërkombëtare":

- Për vitin akademik 2013-2014, është 1 student i regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 2.66. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2014-2015, janë 7 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 3.22. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2015-2016, janë 6 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 2.98. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2016-2017, janë 7 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 3.57. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2017-2018, janë 8 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 3.25. Nuk ka studentë të transferuar.

- Për vitin akademik 2018-2019, nuk ka studentë të regjistruar për herë të parë duke qenë se nuk ka patur kërkesa për këtë profil.

Nga studentët e vitit 2016, 4 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.70.

Nga studentët e vitit 2017, 6 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.50.

Nga studentët e vitit 2018, 5 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.58.

b. Programi Msc. Drejtësi / Profili "E drejtë penale":

- Për vitin akademik 2013-2014, janë 3 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 3.12. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2014-2015, janë 31 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 3.21. Në vitin e dytë të ciklit ka patur 2 studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2015-2016, janë 6 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 3.08. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2016-2017, janë 7 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 2.95. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2017-2018, janë 16 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 2.54. Nuk ka studentë të transferuar.
- Për vitin akademik 2018-2019, janë 10 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare në hyrje 2.49. Nuk ka studentë të transferuar.

Nga studentët e vitit 2013, 2 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.83.

Nga studentët e vitit 2014, 1 student është diplomuar me mesatare dalëse 3.91.

Nga studentët e vitit 2015, 3 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.61.

Nga studentët e vitit 2016, 3 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.15.

Nga studentët e vitit 2017, 12 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.53.

Në vitin 2018, 12 studentë janë diplomuar me mesatare dalëse 3.36.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend (*Tabela 26 e Aneksëve*)

Sic përmendet dhe në RVB, studentët e programit të studimit në fjalë, "për shkak të profilizimit dhe legjislacionit të ndryshëm edhe pse janë hapur thirrje për programe shkëmbimi nuk kanë shfaqur interes për pjesëmarrje në programe shkëmbimi". Sipas informacionit të depozituar nga institucioni, nuk ka raste të mobilitetit të studentëve në universitete jashtë vendit. RVB (fq. 98) përmban një listë universitetesh dhe pas pyetjes gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se universitetet e listuara janë shembuj të institucioneve ku studentët kanë shkuar për të ndjekur studime pas programeve Master apo Bachelor në KU. Pra lista në atë pjesë të raportit nuk reflekton mobilitetin e studentëve në kuadër të programeve të shkëmbimit të studentëve.

- ☑ Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve: numri i të punësuarve në përputhje me diplomën) dhe numri i të punësuarve jo në përputhje me diplomën (Tabela 27 e Anekseve)


Sipas të dhënave të tabelës 28 ("Punësimi i studentëve), numri i të diplomuarve në programin e studimit Msc në Drejtësi për periudhën 2013-2018 është 49. Këtu vihet re një mospërputhje e vogël me të dhënat nga tabelat 25.1 dhe 25.2 ku pasqyrohet cilësia në dalje e studentëve për cdo profil, por dhe numri i të diplomuarve i cili sipas përlllogaritjeve për periudhën 2013-2018 është 48 dhe jo 49.

Sa i takon të punësuarve, janë 38 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 8 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 1 student ka vazhduar studimet pas programit master dhe 2 studentë nuk janë punësuar.

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Statistikat mbi studentët e Msc. Drejtësi, evidencë shtesë
 - Model vlerësimi praktike studentore

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në</p>	<p>Studentët që ndjekin programin master zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 ECTS.</p> <p>Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me nenet 74 dhe 76 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH".</p> <p>Kriteri i gjuhës angleze (por edhe i gjuhëve të tjera të përcaktuara në ligj) është një kriter hyrës.</p>




<p>përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion; Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në institucion funksionon Zyra e Karrierës e cila është përgjegjëse për lidhjen midis studentëve dhe punëdhënësve potencialë. Në përmbushje të detyrave të saj, Zyra e Karrierës informon studentët për mundësitë e punësimit si dhe për praktikat profesionale.</p> <p>Studentëve u jepet informacion për institucioni dhe për programet e studimit që ofrohen, si edhe kanë këshillim karriere.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në secilin nga profilet e programit, duke përfshirë numrin e studentëve të regjistruar, transferimet apo largimet para përfundimit nga programi.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve, duke bërë dallimin midis punësimit në përputhje me diplomën dhe jo në përputhje me diplomën. Gjithashtu ka dhe të dhëna lidhur me studentët të cilët vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	

David R. R. R.

[Signature]

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, organizimin dhe statusin e akreditimit të programit. Institucioni ka miratuar “Guidën e Studentit” (evidenca nr. 42) një dokument orientues lidhur me institucionin, shërbimet e në dispozicion të studentit, zyrat përkatëse, rregullat akademike, çështje administrative dhe të lidhura me programin e studentit (si regjistrimi i lëndëve, metodat e vlerësimit, sezoni i provimeve, diplomimi, procedurat ankimore etj).</p>
---	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim studentëve dhe për këtë qëllim ka krijuar mekanizma ndihmues për ndjekjen e ecurisë së tyre si dhe trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave të lidhura me procesin mësimor. Drejtoria e marrëdhënieve me studentët dhe më konkretisht drejtuesi i saj është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me Kolegjin Universitar “Bedër”. Në varësi të kësaj drejtorie janë zyra e planifikimit të karrierës; zyra e koordinimit të klubeve studentore; zyra e të diplomuarve; zyra e shërbimit psiko-social dhe shëndetësor. Praktika profesionale nuk përbën pjesë të programit të studimit, megjithatë ka patur raste (shih më lart në “Llojet e formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet”) kur studentët janë përfshirë në të tilla praktika.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Pranimi i studentëve në institucion bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”. Studentët që aplikojnë dhe pranohen në këtë program studimi zotërojnë se paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 ECTS
2. Institucioni informon studentët lidhur me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me mundësitë e punësimit.
3. Institucioni mban të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi.
4. Institucioni disponon të dhëna lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në fushat e profilit të programit master ose jo.
5. Institucioni ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ato hasin.

Dimitris Papanicolaou

[Signature]

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor është përfshirë dhe institucionalizuar si veprimtari në aktet bazë të institucionit. Në bazë të nenit 86 të Statutit veprimtaria e kërkimit shkencor në KU synon në rritjen e cilësisë së arsimit. Në bazë të nenit 87 të Statutit “Veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit duhet të sigurojnë integrimin e kërkimit me mësimin. Temat ose afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga njësitë bazë dhe kryesore në bazë të procedurave të përcaktuara në rregulloren e kërkimit shkencor.” Gjithashtu “nxitja dhe mbështetja e pjesëmarrjes aktive të personelit akademik dhe studentëve të programit “Bachelor” dhe “Master” në projekteve dhe veprimtari kërkimore- shkencore” përbën një nga objektivat strategjike të institucionit të përfshirë në Planin Strategjik 2018-2023 (shih “Plani Strategjik 2018-2023 i Kolegjit Universitar ‘Bedër’”, evidenca nr. 22) I njëjti dokument parashikon si nisma për konkretizim rritjen e nivelit të angazhimit dhe produktivitetit të personelit akademik, studentëve të diplomuar dhe atyre aktualë; ofrimin e bursave për motivimin e personelit për rritjen e numrit të publikimeve; rritjen e produktivitetit të organizimit të takimeve të punës (workshopeve), konferencave, seminareve, trajnimeve dhe simpoziumeve, të organizuara në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare; aplikimin për fonde nga Bashkimi Europian dhe institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për projektet kërkimore; krijimin e mekanizmave të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për matjen e rezultateve të aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe ato profesionale.

Neni 8 i Statutit dhe neni 5 i Rregullores Themelore përcakton Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin si një ndër organet drejtuese të institucionit. Në bazë të nenit 15 të rregullores themelore, ky Komision është organi përgjegjës që nxit kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Gjithashtu, anëtarët e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Funkcionet e këtij Komisioni përfshijnë organizimin e veprimtarive kërkimore mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara nga njësitë bazë dhe kryesore si dhe vlerësimin e performancës së punës kërkimore shkencore në të gjitha nivelet, mbështetur në standardet e miratuara nga Senati Akademik në përputhje me standardet kombëtare.

Detyrat e këtij Komisioni janë detajuar dhe në Rregulloren mbi projektet kërkimore shkencore (*evidenca nr. 10*) e cila ka për qëllim “rregullimi[n] [e] procedurës së zhvillimit, aplikimit dhe menaxhimit të projekteve kërkimore në Kolegjin Universitar “Bedër”. Kjo rregullore përcakton Zyrën e Kërkimit Shkencor si përgjegjëse për hartimin dhe admintrimin e politikave për kërkimin shkencor. Kjo zyrë “synon të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë impaktin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit.” (*shih nenin 6 të rregullores*). Kjo rregullore përmend grantet kërkimore të cilat janë në dispozicion të personelit të brendshëm dhe të jashtëm dhe akordohen në bazë të meritës së projektit. Udhëzimi për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor (*evidenca nr. 12*) ndër të tjera përcakton dhe një sistem vlerësimi bazuar në pikë nëpërmjet të cilit mundësohet vlerësimi i stafit akademik në bazë të llojit të publikimit (monografi, botime në revista me impakt etj). Sic është përmendur dhe më lart (*shih pjesën 6 të këtij raporti mbi sigurimin e cilësisë*), institucioni ka hartuar një plan veprimi për objektivat e kërkimit shkencor për implementimin e të cilit është përgjegjës Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

Nga pikëpamja substanciale, Institucioni nuk ka një strategji apo program të kërkimit shkencor i cili përmbledh fushat kryesore të kërkimit shkencor që lidhen me programet e ndryshme të studimit.

Nga shqyrtimi i RVB dhe nga bisedat në institucion bie në sy organizimi i Konferencës Studentore në Drejtësi, Konferenca Ndërkombëtare e Studiuesve të Rinj, si dhe konsolidimi i “Brownbag Seminars in Law” me të ftuar nga fusha të ndryshme të lëmit të së drejtës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (*Tabela 28 dhe 29 e Anekseve*)

RVB në fq.108-138 përmban një listë të publikimeve të stafit akademik për periudhën 2013-2018 si dhe një listë të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, aktiviteteve të tjera të lidhura me kërkimin (brownbag series in law) debatet studentore dhe aktivitetet sociale për të njëjtën periudhë. Të dhënat për publikimet janë përmbledhur dhe në tabelën 29 bashkëngjitur këtij raport.

Nga një shqyrtim i hollësishëm i listës së publikimeve rezulton se:

- 1) Pjesa më e madhe e elementeve të listuara aty janë prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe jo publikime në revista (prestigjioze) akademike brenda ose jashtë vendit. Ndërkohë që këto të dhëna janë paraqitur nga RVB si “botim i shtypur ose open access journal” kategori që janë të ndryshme nga prezantimi në një konferencë apo dhe publikimi në të ashtuquajturat “conference proceedings”.
- 2) Jo në të gjitha rastet lidhja midis prezantimeve/publikimeve dhe programit të studimit në fjalë është e evidente. P.sh publikime si “Workplace spirituality in higher education”, “Shpërndarja e funksioneve kryesore midis organeve kushtetuese dhe marrëdhënit që lindin midis këtyre organeve”, “Trajtimi i figurës së Sami Frashërit [...]”, “Separation of the state from religion [...]” nuk lidhen me programin e studimit.

Nga një shqyrtim i hollësishëm i listës së aktiviteteve rezulton se institucioni ka organizuar konferencat e mëposhtme:

- Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Studiueve të Rinj (2013-2014)
- Konferenca e Dytë Studentore në Drejtësi (2013-2014)
- Konferenca e Tretë Studentore në Drejtësi (2014-2015)
- Konferenca e Katërt Studentore në Drejtësi (2015-2016)
- Workshop në bashkëpunim me Universitetin e Barit (2015-2016)
- Konferenca Ndërkombëtare “Korniza ligjore për bashkëpunimin ndërshtetëror në mënaxhimin e krizave të emigracionit dhe refugjatëve” (2016-2017)

Një nismë pozitive, e cila duket të jetë një aktivitet i konsoliduar në institucion, është “Brownbag series in law”. Ndërkohë RVB liston si aktivitete në kuadër të kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjen e studentëve të KU në konkursin ndërkombëtar të së drejtës ndërkombëtare Jessup: megjithë prestigjin e këtij aktiviteti, pjesëmarrja në të nuk reflekton angazhim të stafit akademik në kërkim shkencor, por është evidencë e përfshirjes së studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare.

Nga një shqyrtim i hollësishëm i CV-ve të stafit akademik, rezultojnë këto të dhëna lidhur me publikimet:

F.Xh: 7 publikime kryesisht në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjithashtu në dokumentacion nuk ka informacion të saktë lidhur me revistën apo vitin e botimit.

F.Gj: 9 publikime në *conference proceedings* kryesisht në çështje të marrëdhënieve ndërkombëtare, sigurisë; prezantime të shumta në konferenca (por jo në lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit); 5 botime në revista shkencore; si dhe botime të tjera.

N.B: prezantime në konferenca në Shqipëri; tre botime në revista shkencore (ndër to dhe me relevancë për programin e studimit) dhe tre botime në *conference proceedings*.

B.H: sipas dokumentacionit, 1 publikim në revistën *Jornal of Legal Studies*.

G.S: 4 publikime në revista shkencore, ndër to dhe me relevancë për programin e studimit; disa prezantime në konferenca në Shqipëri.

A.Q: nuk ka publikime.

B.U: 5 publikime në *conference proceedings*, pjesëmarrje në konferenca në Shqipëri. Nuk ka publikime në revista shkencore.

E.Sh: nuk ka publikime.

E.B: nuk ka publikime.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Plan veprimi për objektivat e kërkimit shkencor integrimin e studentëve dhe stafit të huaj

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në	

kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Sipas të dhënave të dokumentuara rreth gjysma e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit nuk kanë publikime në revista shkencore kombëtare ose ndërkombëtare. Shumica e stafit akademik kanë publikime në <i>conference proceedings</i> përgjithësisht në konferencat e organizuara nga institucioni. Gjithashtu, jo gjithmonë publikimet i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë programit të studimit.</p> <p>Duke parë anagazhimin modest nga pikëpamja sasiore dhe cilësore të stafit nëpërmjet publikimeve, mund të thuhet se personeli akademik bën përpjekje për zhvillimin e shkencës - sidomos më pjesëmarrje në konferenca - por gjithsesi ky kontribut mbetet shumë modest dhe në nevojë për zhvillim dhe inkurajim të mëtejshëm.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Anëtarë të personelit akademik të cilët zgjedhin të zhvillojnë lëndën e tyre në gjuhën angleze kanë kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikatë për njohje të avancuar të saj.</p> <p>Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni (<i>shih "Lista e trajnimeve të stafit akademik dhe administrativ", evidenca nr. 32</i>) si dhe nga biseda në institucion, vihet re se ky i fundit i ofron stafit akademik mundësi për trajnime të vazhdueshme p.sh. lidhur më strategjitë e publikimit apo të mësimdhënies, për organizimin e arkivës, për shkruajtjen e projekt-propozimeve etj.</p> <p>Gjithashtu gjatë bisedës në institucion GVJ u</p>

	informua për rastin e një anëtari PAE i cili pa shkëputje kontratë më institucionin vazhdoi studimet pasuniversitare jashtë Shqipërisë. Mbështetje financiare për kërkim shkencor u konfirmua nga një rast tjetër i stafit PAK.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	Institucioni disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. Një burim i këtyre të dhënave janë jetëshkrimet e secilit anëtar të stafit akademik.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Një pjesë e personelit akademik të programit të studimit angazhohet në kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, publikimeve në <i>conference proceedings</i> apo në revista shkencore. Megjithatë ky kontribut mbetet modest dhe në nevojë për inkurajim dhe zhvillim të mëtejshëm si nga pikëpamja sasiore por dhe cilësore. 2. Pjesë të programit të studimit ofrohen në gjuhën angleze nga personel akademik i kualifikuar. 3. Institucioni i ofron mundësinë e kualifikimeve të vazhdueshme stafit akademik nëpërmjet trajnimeve të organizuara në institucion apo mbështetjes për studime të mëtejshme. 4. Institucioni disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e stafit akademik. 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni rezulton të ketë marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike të rajonit e më gjerë në të cilat përfshihen shkëmbime dhe mobilitet edhe në drejtim të konsolidimit të ekspertizës akademike në fushat e përbashkëta të studimit.

Institucioni ka lidhur marrëveshje me Universitete të huaja kryesisht në Turqi si: Universiteti Suleyman Şah Universiteti Fatih, Universiteti Ondokuz Mayiz, Universiteti Gediz, Universiteti Ndërkombëtar Burch Universiteti Ataturk, Universiteti Ordu, Kolegji Amerikan Islamik, Universiteti Izmir Katip, Universiteti Ndërkombëtar i Detit të Zi, Universiteti Ishik, Universiteti Agora, etj por edhe në rajon Evropë e SHBA si, Universiteti i Romës “Tor Vergata” Universiteti Eastern Mediterranean Universiteti i Ljublanës Universiteti i Kalabrisë Universiteti i Barit Universiteti i Pensilvanisë Kaliforni etj. Bashkëpunimet përfshijnë kryesisht aktivitete të tilla si shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore.

Gjithashtu, Institucioni ka zhvilluar bashkëpunime me Institucione të Arsimit të Lartë vendase publike dhe jo publike si Universiteti i Tiranës, Universiteti Epoka, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”, Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Çabej”, për qëllime shkëmbimi të stafit dhe studentëve, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, etj. Edhe me Shkollën e Magjistraturës raportohet pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore, përfshirë edhe institucione të drejtësisë dhe subjekte të tjera në sektorin e drejtësisë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, Shoqata e penalistëve shqiptarë, Shërbimi i Provës, Studio Pëmbarrimore BEST 2000, Studio Ligjore “Qinami” etj. Lista e plotë e marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjektet përkatëse gjenden në Anekset e Raportit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:


- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Sipas të dhënave në RVB në lidhje me aktivitetet e zhvilluara si rezultat i pjesëmarrjes në projekte bashkëpunimi kombëtare dhe ndërkombëtare është si më poshtë:

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare 4; Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore 20; Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit 4; Mobiliteti i studentëve nga/dhe drejt IAL 5; Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor 6; Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 115.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

Institucioni ka lidhur marrëveshje me një numër të përshtatshëm Universitetesh të huaja në rajon dhe Evropë, ShBA, etj, si dhe me Institucione të Arsimit të Lartë vendase publike dhe jo publike. Gjithashtu, institucioni mban kontakte të vazhdueshme me institucione të sektorit të drejtësisë me qëllim zhvillimin e programit dhe nxitjen e ndjekjes së tij. Edhe me Shkollën e



Magjistraturës raportohet pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore, përfshirë edhe institucione të drejtësisë dhe subjekte të tjera në sektorin e drejtësisë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, Shoqata e penalistëve shqiptarë, Shërbimi i Provës, Studio Pëmbarrimore BEST 2000, Studio Ligjore “Qinami”, etj.

Të dhëna të plota mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit dhe marrëdhëniet me institucione e subjekte të tjerë në sektorin e drejtësisë gjenden në Tabelën 30 dhe 31 të Aneksëve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Programi Master Shkencor në të 2 profilet e Drejtë Penale dhe e Drejtë Ndërkombëtare nuk përfshin praktikë, një mangësi që u adresua edhe me përfaqësuesit e Institucionit. Programi sidoqoftë përmbush orët praktike në lëndë të ndryshme të cilat mund të zhvendosen në kredite të ndara praktike brenda programit. Gjithashtu ka lëndë të cilat kanë karakter praktik siç është evidencuar më sipër; mund të shërbejnë për fitimin e krediteve të proaktikës.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni reflekton frymë bashkëpunimi dhe lidhje efikase e bashkëpunuese midis niveleve e strukturave të tij. Spikat rregullimi i cdo aktiviteti e veprimtarie me rregullore të posaçme, një tipar i zhvilluar në të gjitha drejtimet. Mund të këtë një thjeshtësim të strukturave dhe bashkim të disa detyrave, psh. në drejtim të koordinatorëve të programeve ka një ndarje të trefishtë në disa nivele që mund të përqëndrohet, etj. Komunikimi midis stukturave e njësisë karakterizohet nga një frymë pozitive bashkëpunimi që u evidencua edhe në takimet për grupin e ekspertëve.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	




Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.


Institucioni ka lidhur marrëveshje me një numër të përshtatshëm Universitetesh të huaja në rajon dhe Evropë, ShBA, etj., si Universiteti Izmir Katip, Universiteti Ndërkombëtar i Detit të Zi, Universiteti, Ishik, Universiteti Agora etj por edhe në rajon Evropë e SHBA si, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Universiteti Eastern Mediterranean Universiteti i Ljubljanes Universiteti i Kalabrisë Universiteti i Barit Universiteti i Pensilvanisë Kaliforni etj. Bashkëpunimet përfshijnë kryesisht aktivitete të tilla si shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore.

Gjithashtu, Institucioni ka zhvilluar bashkëpunime me Institucione të Arsimit të Lartë vendase publike dhe jo publike si: Universiteti i Tiranës, Universiteti Epoka, Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu", Universiteti i Gjirokastrës "Eqerem Çabej", për qëllime shkëmbimi të stafit dhe studentëve, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, etj. Edhe me Shkollën e Magjistraturës raportohet pjesëmarrje në projekte të përbashkëta shkencore, përfshirë edhe institucione të drejtësisë dhe subjekte të tjera në sektorin e drejtësisë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, Shoqata e penalistëve shqiptarë, Shërbimi i Provës, Studio Pëmbarrimore BEST 2000, Studio Ligjore "Qinam", etj.

Në takime u evidentua që nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të ndryshme dhe komunikimeve të drejtpërsëdrejta me përfaqësues të institucioneve të sektorit të drejtësisë përcillet informacion mbi zhvillimin e programit me qëllim dhe nxitjen e ndjekjes së tij. Një vlerësim i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit bëhet në aktet e vlerësimit periodik të programit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi Master Shkencor në të dy profilet nuk përfshin praktikë, megjithëse përmbush orët praktike në lëndë të ndryshme të cilat mund të zhvendosen në kredite të ndara praktike brenda programit.
2. Në organizimin e Institucionit, spikat rregullimi i çdo aktiviteti e veprimtarie me rregullore të posaçme, një tipar i zhvilluar në të gjitha drejtimet. Sidooqftë, mund të këtë një thjeshtësim të strukturave dhe bashkim të disa detyrave, psh. në drejtim të koordinatorëve të programeve, bashkërenduesve etj., për të evituar konfuzionin e mbivendosjet me detyra.
3. Institucioni reflekton një organizim efikas e bashkëpunues midis niveleve e strukturave të tij; komunikimi midis strukturave e njësisve karakterizohet nga një frymë pozitive bashkëpunimi.
4. Institucioni ka lidhur marrëveshje me një numër të përshtatshëm Universitetesh të huaja në rajon dhe Evropë, ShBA, etj, si dhe me Institucione të Arsimit të Lartë vendase publike dhe jo publike.
5. Institucioni mban kontakte të vazhdueshme me institucione të sektorit të drejtësë me qëllim zhvillimin e programit dhe nxitjen e ndjekjes së tij.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

a. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të krijohen mundësitë për të arritur në nivelin e kërkuar të përqindjes së stafit të brendshëm dhe kualifikimi i një pjese të tij në krahasim me atë të jashtëm.
- b) Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e institucionit.
- c) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.


b. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin “a”, GVJ konstaton se që nga akreditimi i mëparshëm, Institucioni ka bërë përpjekje për rritjen e numrit të personelit akademik efektiv (PAE) - në krahasim me atë të jashtëm (PAK) - të angazhuar në programin e studimit. Numri më i lartë i PAE ndër vite rezulton në vitin akademik 2017-2018. Gjithashtu, vihet re një përpjekje për përmbushjen e kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi duke angazhuar personel akademik me kualifikimin Doktor i Shkencave e sipër në nivelin e titullarëve të lëndëve. **Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet i plotësuar.**
- b) Për rekomandimin “b”, GVJ vë re se Institucioni ka marrë masa për rritjen e numrit të titujve në bibliotekën e Institucionit si dhe titujve elektronikë. Megjithatë fondi i bibilotekës duhet përditësuar me tituj bashkëkohorë si dhe ai duhet të përfshijë tekstet dhe materialet e detyrueshme për të gjitha lëndët e ofruara për programin e studimit. **Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet kryesisht i plotësuar por në nevojë për t’u zhvilluar e konsoliduar më tej.**
- c) Për rekomandimin “c”, GVJ vë re se në disa lëndë të programit, gjuha angleze përdoret - plotësisht ose pjesërisht – si gjuhë e mësimdhënies. Gjithashtu, njohja e një nga pesë gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) në nivelin B1 konsiderohet si kriter hyrës në programin e studimit në fjalë. Kriteri i njohjes së një nga pesë gjuhët e lartpërmendura është në përputhje me nenin 76(4) të Ligjit për Arsimin e Lartë. **Për këto arsye, GVJ konkludon se ky rekomandim mund të konsiderohet i plotësuar.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES-PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT)

a. Pika të forta:

1. Institucioni ka një rregullim të spikatur dhe të detajuar në drejtim të organizimit struktural dhe të gjithë veprimtarive të tij akademike, shkencore e administrative. Ky rregullim është



aspekt pozitiv në drejtim të respektimit të qëndrueshëm të kuadrit rregullator e të drejtave e detyrimeve të subjekteve.

2. Personeli akademik PAE dhe PAK i angazhuar pranë programit është përgjithësisht personel akademik me eksperiencë të gjatë në institucionet e arsimit të lartë, disa me edukim në programe të huaja.
3. Qasja e përfaqësuesve të institucionit është e hapur dhe konstruktive ndaj sugjerimeve e observimeve, tregues i vullnetit pozitiv e të sinqertë për të adresuar ndryshimet e nevojshme.
4. Ofrimi i disa lëndëve të programit në gjuhën angleze është element pozitiv në drejtim të qasjes së programit ndaj programeve të huaja dhe mundësisë së mobilitetit nga dhe drejt institucionit.
5. Fusha e së drejtës penale që përbën dhe një nga profilet e programit të studimit paraqet rëndësi studimi të thelluar sidomos në kuadër të ndryshimeve kushtetuese dhe rregullimeve të reja në fushën e drejtësisë penale.
6. Komisioni dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë institucione të ngritura dhe të rregulluara në mënyrë të detajuar në bazë të rregulloreve përkatëse.
7. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetin ndërkombëtar të gjyqit imitues “Jessup”, organizimi i disa konferencave si dhe organizimi i “Brownbag Seminars in Law”.

b. Pika të dobëta:

1. Përshtatja e profilit të personelit akademik me fushën e studimit të lëndës duhet të jetë më në vemendje.
2. Programi nuk përfshin praktikë megjithëse programi përfshin orë praktike në lëndë të tij.
3. Kriteret e pranimit lidhur me fushën e studimit të ciklit të parë (bachelor) janë formuluar në mënyrë të gjerë duke përfshirë dhe studentë që kanë përfunduar studime në ciklin e parë në fusha jo të afërta me drejtësinë.
4. Biblioteka e institucionit përgjithësisht plotëson nevojat themelore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, titujt nuk janë të përditësuar dhe për pasojë nuk reflektojnë debatin akademik bashkëkohor. Gjithashtu, jo për të gjitha lëndët, literatura e detyrueshme gjendet në bibliotekën e institucionit.
5. Megjithë institucionalizimin e Komisionit dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, këto dy organe nuk veprojnë mbi bazën e një plan veprimi të detajuar me përjashtim të monitorimit të kërkimit shkencor. Gjithashtu aktivitetet monitoruese kanë karakter përgjithësisht të shpërndarë, siç është evidentuar në raport (fq. 38).
6. Angazhimi i personelit akademik në kërkim shkencor cilësor mbetet në nivele modeste dhe në nevojë për inkurajim dhe zhvillim të mëtejshëm si nga pikëpamja sasiore por dhe cilësore.

c. Mundësitë:

1. Programi mund të përfitojë efektivisht nga bashkëpunimi me institucione vendase e të huaja sidomos në kuadër të interesit të lartë për studime të thelluara në fushën e së drejtës penale pas ndryshimeve kushtetuese e ligjore në sektorin e drejtësisë penale.



2. Vendndodhja e institucionit në Tiranë pranë institucioneve shtetërore sidomos edhe atyre të sektorit penal dhe pranë organizatave ndërkombëtare ofron mundësi shumë të mira për përfshirjen e praktikave profesionale në program.
3. Hapësirat e Institucionit janë të përshtatshme dhe të favorshme për të zhvilluar programin dhe për ta përmirësuar atë.
4. Ka mundësi të mira aplikimi për grante kërkimore/mobiliteti sidomos në kuadër të projekteve e programeve të financuara nga Komisioni Evropian, por jo vetëm.
5. Syllabuset aktuale të lëndëve përbëjnë një bazë të mirë për përmirësimin e programit; programi ka vend për përmirësim të kurrikulës në disa drejtime në mënyrë që të sigurohet koherenca e brendshme e syllabuseve si dhe koherenca me objektivat e programit të studimit në fjalë.

d. Pengesat:

1. Mund të jetë i nevojshëm lehtësimi i zinxhirit të strukturave e hallkave të shumta për të thjeshtuar proceset dhe evituar mbivendosjet.
2. Numri i ulët i studentëve veçanërisht, siç u evidentua dhe gjatë vizitës në institucion, sidomos në profilin “E drejtë ndërkombëtare”.

Rekomandime:

1. Rekomandohet që institucioni të sigurojë përshtatje të plotë midis lëndëve të programit dhe profilit të stafit akademik që angazhohet në mësimdhënie në ato lëndë.
2. Edhe pse syllabuset aktuale të lëndëve përbëjnë një bazë të mirë për zhvillimin e programit të studimit, rekomandohet që ato të rishikohen nga njësitë përkatëse me qëllim përmirësimin e kurrikulës në disa drejtime në mënyrë që të sigurohet koherenca e brendshme e syllabuseve si dhe koherenca me objektivat e programit të studimit në fjalë.
3. Rekomandohet që institucioni të rishikojë rregulloret e strukturës organizative dhe të veprimtarisë akademike, shkencore dhe administrative me qëllim thjeshtimin e proceseve vendimmarrëse, evitimin e mbivendosjeve, etj.
4. Rekomandohet që institucioni të përfshijë praktikën mësimore si pjesë integrale të programit të studimit.
5. Rekomandohet që institucioni të rishikojë kriteret e pranimit në programin master duke qenë se këto kritere lidhur me fushën e studimit të ciklit të parë (bachelor) janë formuluar në mënyrë shumë të përgjithshme duke e lënë të hapur edhe për fusha jo të afërta me drejtësinë.
6. Rekomandohet që institucioni të marrë masa konkrete për përditësimin e titujve në bibliotekë me qëllim që të reflektohet debati akademik bashkëkohor si dhe të sigurojë që literatura e detyrueshme për lëndët e programit të jetë e pranishme në bibliotekë.
7. Rekomandohet që institucioni të hartojë një plan të qartë veprimi lidhur me veprimtarinë e Komisionit dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu masa duhen marrë me qëllim që aktivitetet monitoruese të jenë të mirëorganizuara me qëllim përmbushjen e detyrave të këtyre njësisë siç janë përcaktuar në aktet rregulluese.

Janina B. B. B.

[Signature]

8. Duke qenë se angazhimi i personelit akademik në kërkim shkencor cilësor mbetet në nivele modeste si në sasi dhe në cilësi, rekomandohet që institucioni të marrë masa për inkurajimin dhe përmirësimin e rezultateve të kërkimit shkencor si nga pikëpamja sasiore por dhe cilësore.


III. SUMMARY OF THE ANALYSIS ON THE ASSESSMENT OF THE STUDY PROGRAMME

a. Strengths:

1. The institution functions based on detailed rules and regulations concerning its organizational structure as well as its academic, scientific and administrative activities. This level of regulation is a positive aspect towards ensuring a sustainable compliance with the regulatory framework in force and with rights and obligations of parties.
2. Academic staff (full time or on contract) teaching in this programme, generally displays a long experience in Albanian high education institutions. Part of this staff has studied abroad.
3. Representatives of the institution show an open and constructive approach to observations and suggestions. This testifies for good will in addressing necessary changes.
4. The fact that some subjects are offered in English is a positive element vis-à-vis international programmes and mobility opportunities to and from the institution.
5. The field of criminal law, that constitutes one of the profiles of this study programme, is an important field for in-depth research and study especially in the context of the recent constitutional amendments and the new legal framework in this field.
6. The Commission and the Unit for Quality Assurance are set up as organs and their functioning is regulated in a detailed manner by respective regulations.
7. The participation of students in the international moot court competition "Jessup", the organization of several conferences and of the "Brownbag Seminars in Law".

b. Weaknesses:

1. The academic and research profile of academic staff engaged in teaching should be observed in the assignment of subject matter of courses to the academic staff.
2. The program does not include professional practice as an integral part of the curricula, although practice is part of the syllabus of several courses.
3. The admission criteria concerning first level studies (bachelor) are formulated in a general manner by including as potential students to the study programme students who does not have a bachelor degree in a subject area relative to law.
4. Generally the library fulfills the basic needs of teaching activities and research. Nevertheless, not all titles are updated and as a consequence they do not reflect the most contemporary academic debate. Also, mandatory titles in some subjects cannot be found in the library of the institution.
5. Regardless the setting up of the Commission and Unit for Quality Assurance, these two organs do not function based on a detailed action plan with the exception of the monitoring of scientific research. In addition, monitoring activities of these two organs are generally scattered as it has been identified in the report (pg.38).



6. The involvement of academic staff in quality scientific research remains at low levels and it needs further encouragement and development, both from a quantitative and qualitative perspective.

c. Opportunities:



1. The programme may effectively benefit from cooperation with local and international institutions especially in the context of the high interest for advanced studies in the field of criminal law after Albania's constitutional amendments in the field of criminal justice.
2. Location of the institution in Tirana close to state institutions and international organizations offers a very good possibility for the inclusion of professional practices in the curricula.
3. The infrastructure of the institution is suitable for the programme and for further improving it.
4. Plenty of opportunities for grant applications for research and mobility especially in the context of programmes financed by the European Commission (but not only).
5. Current syllabi represent a good basis for further improving the programme; syllabi may be further improved in order to ensure their internal coherence and compatibility with objectives of the study programme.

d. Threats:

1. The multi-layered and detailed regulatory framework concerning the chain of structures of the institution may be simplified to facilitate the decision making processes and avoid overlaps, etc.
2. The low number of students especially in the profile "International Law".

Recommendations:

1. It is recommended that the institution guarantees full compliance between the subjects taught and the (scientific/research) profile of academic staff who is in charge of teaching in respective subjects.
2. Even though current syllabi represent a good basis for the study programme, it is recommended that they are revised by respective units so that their internal coherence is ensured as well as their coherence with the objectives of the study programme.
3. It is recommended that the institution simplifies some organizational structure and academic, scientific and administrative activity to facilitate the decision-making processes and avoid overlaps, etc.
4. It is recommended that the institution includes professional practice as integral part of the study programme.
5. It is recommended that admission criteria concerning first level studies (bachelor) are reviewed as they are very broad including as potential students to the study programme students who do not have a bachelor's degree in a subject area relative to law.



6. It is recommended that the institution takes concrete measures for updating the titles in the library so that the study programme reflects the contemporary academic debate. Also mandatory readings should be made available in the library.
7. It is recommended that the institution drafts a clear action plan on the activities of the Commission and Unit on Quality Assurance. In addition, measures should be taken that their activities are well-organized with a view of fulfilling the tasks of these institutions as determined by their regulatory acts.
8. Given that the inclusion of academic staff in quality academic research remains in low levels concerning both quantity and quality, it is recommended that the institution takes measures in order to encourage and improve research output from a quantitative and qualitative perspective.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Evis Alimehmeti
2. Dr. Darinka Piqani

